

QËNDRO!

SISTEMI I PARALAJMËRIMIT TË HERSHËM

Manual për parandalimin e braktisjes së shkollës

Për ofruesit e AFP-së në Shqipëri

Pjesa I



Mirënjohje

Manuali për parandalimin e braktisjes së shkollës për shkollat e Arsimit Formimit Profesional (*Pjesa e parë*) u hartua bashkërisht nga Laetitia Antonowicz (Konsulente e UNICEF-it), në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive (AKPA) dhe Qendrën për Aftësi Konkurruese (CCS), në kuadër të projektit QËNDRO, financuar nga Qeveria Italiane. Ky manual bazohet në përvojën dhe punën e UNICEF-it për parandalimin e braktisjes së shkollës në Evropë dhe Azinë Qendrore që nga viti 2012, si dhe në publikimet e mëparshme të UNICEF ECARO mbi këtë temë. Ai është përshtatur me kujdes për të adresuar nevojat specifike të Arsimit dhe Formimit Profesional (AFP) në Shqipëri.

Përmes këtij manuali, synohet të ofrohet një udhëzues praktik për shkollat e AFP-së në Shqipëri, duke përfshirë strategji dhe masa konkrete për parandalimin e braktisjes së shkollës. Manuali përmban informacione të vlefshme për mësuesit, drejtuesit e shkollave dhe politikëbërësit, duke synuar krijimin e një mjedisi mbështetës dhe motivues për nxënësit që janë në rrezik të lënies së hershme të shkollës.

Manuali gjithashtu ofron një pasqyrë të faktorëve që kontribuojnë në braktisjen e shkollës, si dhe praktikatat më të mira për t'i adresuar këto sfida. Duke u bazuar në studimet dhe përvojat ndërkombëtare, ai ofron një kornizë të qartë dhe të strukturuar për zbatimin e politikave dhe programeve efektive për parandalimin e braktisjes së shkollës në Shqipëri.

Përmbajtja

1. Hyrja	3
2. Kuptimi i braktisjes.....	6
Përkufizimet	6
Pikat e rrezikut të braktisjes	6
Faktorët e braktisjes	8
3. Sistemet e Paralajmërimit të Hershëm për parandalimin e braktisjes.....	14
Qasja e të gjithë shkollës ndaj parandalimit të braktisjes	14
Sistemet e Paralajmërimit të Hershëm për parandalimin e braktisjes.....	15
Aneks 1. Pyetësor për pikat e forta dhe vështirësitë e adoleshentit.....	19
Aneks 2. Shkalla e mirëqenies së adoleshentit	21
Burime shtesë	39
Detyrë	39
4. Planifikimi i shkollës për parandalimin e braktisjes	40
Procesi i planifikimit.....	40
Detyra të punës në grup	51
Detyra 1: Analiza e situatës.....	51
Detyra 2: Sistemi i Paralajmërimit të Hershëm të braktisjes.....	52
Detyra 3: Plani i parandalimit të braktisjes së shkollës	53
Aneks 3. Shabllon i Planit të Parandalimit të Braktisjes së Shkollës.....	54
Aneks 4. Raste Studimore për AFP	55
Aneks 5. Burime Shtesë	58
Aneks 6. Bibliografia	59

Hyrja

Konteksti dhe objektivat

Konteksti

Pavarësisht një sërë reformash në arsim dhe politika të punës në dekadat e fundit, Shqipëria vazhdon të përballlet me probleme të mëdha në lidhje me arsimin dhe rezultatet e punës.

Ndërsa rezultatet e PISA tregojnë se Shqipëria ka qenë një nga vendet që ka bërë përparimin më të lartë në rezultate në dekadën e fundit, shumica ose pothuajse gjysma e 15-vjeçarëve shqiptarë kanë performancë të ulët në lexim, matematikë dhe shkencë. Në vitin 2018, 52% e 15-vjeçarëve nuk arritën nivelin bazë të aftësisë në lexim (mesatarja e OECD: 23%), 42% e nxënësve nuk arritën nivelin bazë të aftësive në matematikë (mesatarja e OECD 24%) dhe 47% e nxënësve nuk arritën nivelin bazë të aftësive shkencore (mesatarja e OECD 22%).

Tendencat e fundit në **AFP tregojnë një rënie të regjistrimit** (rreth 17.000 nxënës më pak në 2020-2021 krahasuar me 2019-2020), megjithëse është e mundur që pandemia të ketë pasur ndikim në vendimin e të rinjve për të ndjekur arsimin për arsye ekonomike të lidhura me pandeminë. Krahasuar me vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor, Shqipëria ka shkallën më të ulët të pjesëmarrjes në AFP. Pavarësisht reformave, sistemi i AFP-së vazhdon të vuajë nga një mospërputhje ndërmjet drejtimeve të AFP-së, aftësive profesionale të lidhura me punën nga nxënësit dhe nevojave e kërkesave të tregut të punës.


Shumë pak vajza regjistrohen në AFP, me një përqindje prej 15%. Ky **çekuilibër gjinor** jo vetëm që vepron si një pengesë për vajzat e tjera që të drejtohen drejt arsimit profesional, por gjithashtu kufizon kërkesën për një gamë më të gjerë të drejtimeve të AFP-së që tërheqin si djemtë ashtu edhe vajzat. Në përgjithësi, familjet dhe nxënësit vazhdojnë të preferojnë rrugët e arsimit të përgjithshëm mbi ato të arsimit profesional për shkak të perceptimeve negative të sistemit të AFP-së dhe mundësive të punës që ato ofrojnë. Normat gjinore në lidhje me drejtimet ose profesionet e duhura për vajzat dhe djemtë gjithashtu bëjnë që familja dhe nxënësit shpesh të preferojnë arsimin e përgjithshëm përkundërt AFP-së, veçanërisht vajzat.

Sistemi arsimor nuk po u ofron të rinjve aftësitë për jetën dhe punën që do t'u mundësonte atyre të hyjnë me besim dhe të qëndrojnë në tregun e punës, duke përfshirë rrugët e vetëpunësimit dhe sipërmarrjes, të cilat kërkojnë njohuri, aftësi dhe qëndrime thelbësore që ndihmojnë në transformimin e ideve në veprim, që mbështesin inovacionin dhe kontributin për komunitetin dhe që u mundësojnë të rinjve të krijojnë një biznes të qëndrueshëm. Rezultatet e ulëta të arsimit ndikojnë drejtpërdrejt në rezultatet e punës.

Norma NEET për grupin 15-24 vjeç ishte 26.5% në 2018, 25.5% në 2019, 26.6% në 2020 dhe 24.0% në 2021.

Braktisja në shkollat e AFP-së është një faktor që nuk ka marrë vëmendjen e duhur për t'u matur apo parandaluar nga institucionet monitoruese. **Ky projekt, për herë të parë do të trajtojë parandalimin e braktisjes në mënyrë të strukturuar në AFP në Shqipëri.**

Gjatë fazës së grumbullimit të informacionit për zbatimin e Sistemit të Paralajmërimit të Hershëm, është konstatuar se **burimet statistikore janë të kufizuara dhe se nuk ka as studime të mirëfillta për braktisjen** në arsimin profesional në Shqipëri. Megjithatë, nëse i referohemi të dhënave zyrtare të UIS (2023), konstatohet se shkalla e përfundimit me sukses të programeve në arsimin e mesëm të lartë në Shqipëri ka një tendencë në rritje (UIS, 2023).



Grafiku 1: Shkalla e përfundimit me sukses të programeve në arsimin e mesëm të lartë (2012-2020)

Sa i përket legjislacionit shqiptar, si në ligjin nr.69/2012 “Për sistemin arsimor para universitar në Republikën e Shqipërisë” (69, 2012), ashtu edhe në ligjin nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, nuk ka përcaktime të qarta në lidhje me dy llojet e braktisjes: braktisjen fizike dhe braktisjen e fshehur. Megjithatë, struktura e organizimit dhe menaxhimit të AFP-së, përmes Udhëzimit nr.14, datë 27.5.2021 “Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë së institucioneve të arsimit dhe formimit profesional, si dhe aspektet e menaxhimit të burimeve njerëzore, përbërjes së njësive të zhvillimit të ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit” lë më shumë hapësirë veprimi për parandalimin e braktisjes në AFP. Në dallim nga arsimi i përgjithshëm, AFP ushtron disa funksione dhe përmban disa struktura të cilat e lehtësojnë zbatimin e projektit për ngritjen e Sistemit të Paralajmërimit të Hershëm, të nxënësve socio-emocional dhe përfitimin e mini-granteve.

Disa prej tyre renditen më poshtë:

- Njësia e zhvillimit si strukturë e brendshme e ofruesit të AFP-së, e cila planifikon dhe realizon veprimtari zhvillimore në mbështetje të ngritjes së kapaciteteve të brendshme dhe rritjes së cilësisë. Këtu cilësojmë rolin e koordinatorit për orientimin në karrierë, koordinatorit për gjurmimin, koordinatorit për hartimin e projekteve.
- Specialisti i të dhënave statistikore mbledh, regjistron, përpilon dhe përditëson rregullisht të dhënat e AFP-së.
- Përgjegjësi i financës vepron në kuadër të autonomisë financiare që i lejohet ligjërisht për AFP.
- Specialisti i TIK, i cili ndër të tjera harton udhëzues, menaxhon dhe siguron mbështetje teknike të platformave digjitale në mbështetje të mësimdhënies, administrimit apo raportimit. Si i tillë, mund të kontribuojë në zhvillimin e instrumenteve digjitale për SPH.

Përsa i takon dispozitave të tjera ligjore, ato e cekin **braktisjen kryesisht nga ana administrative** lidhur me evidentimin, ndjekjen dhe raportimin e mungesave, lëvizjen dhe transferimin e nxënësve.

Dy nene të Udhëzimit 14, përkatësisht nenet 59 dhe 105 parashikojnë disa mekanizma të cilat mund të vlerësojnë më në thellësi problemin dhe të zhvillojnë edhe aktivitete parandaluese. Përkatësisht

neni 59 rregullon rolin e punonjësit psiko-social, ndërsa neni 105, rregullon komunikimin e mësuesit kujdestar me personat që kanë përgjegjësinë prindërore.

Në funksion të parandalimit të braktisjes, mund të përmendim zhvillimin e disa politikave që synojnë krijimin e **mundësisë për çdo nxënës që përfundon arsimin bazë të regjistrohet në arsimin e mesëm të lartë**, përmes:

- Urdhrit nr.313 dt. 20.10.2020 “Për organizmin dhe Funksionimin e Shërbimit Psiko–Social në institucionet e arsimit parauniversitar dhe procedurat e emërimit, pezullimit dhe largimit në shërbimin psiko-social”.
- Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 119, datë 01.03.2023 “Për përdorimin e fondeve publike për transportin e punonjësve arsimorë që punojnë dhe të nxënësve që mësojnë jashtë vendbanimit”.
- Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 666 dt. 10.10.2019 “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa dhe konvikte dhe përcaktimi i kriterëve të përfitimit të bursave dhe pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike”.

Në bashkëpunim me AKPA dhe referuar rregulloreve dhe akteve ligjore si më sipër, garantohej që trajnimi i personave përgjegjës në shkollat e Arsimit Profesional për zbatimin e Sistemit të Paralajmërimit të Hershëm bazuar në manualin më poshtë, të sigurojë një sistem të qëndrueshëm dhe bashkëkohor në përgjigje të nevojave të sistemit.

Objektivat e manualit

Ky manual synon t'u sigurojë shkollave njohuritë, aftësitë, qëndrimet dhe mjetet për të identifikuar nxënësit që janë në rrezik të braktisjes dhe për të zbatuar ndërhyrje për parandalimin dhe reagimin ndaj saj.

Manuali i qaset të gjithë stafit në shkolla, duke përfshirë drejtorët e shkollave, mësuesit dhe personelin tjetër të shkollës si psikologët shkollor, bordet e shkollave, drejtorët dhe kujdestarët e konvikteve.

Manuali mund të përdoret gjithashtu si referencë nga autoritetet arsimore, inspektorët, këshilluesit dhe OJF-të që punojnë me shkollat, fëmijët dhe adoleshentët e marginalizuar ose në rrezik braktisje.

Organizimi i manualit

Manuali është i organizuar si më poshtë:

- Kapitulli 2 ndihmon për të kuptuar procesin e braktisjes së shkollës dhe faktorët kryesorë që i shtynë nxënësit të braktisin arsimin e mesëm të përgjithshëm dhe AFP.
- Kapitulli 3 fokusohet në mënyrën se si zhvillohet një Sistem i Paralajmërimit të Hershëm për parandalimin e braktisjes së shkollës.
- Kapitulli 4 paraqet një sërë Mjetesh që fokusohen në masat parandaluese që mund të zbatohen nga shkollat.
- Kapitulli 5 ofron informacion mbi planifikimin e qasjes së të gjithë shkollës për parandalimin e braktisjes së shkollës.

- Kapitulli 6 ofron një sërë Detyrash që shkollat dhe ekipet e shkollave mund të ndërmarrin për të kuptuar më mirë fenomenin e braktisjes së shkollës, në shkollat dhe komunitetet e tyre dhe për të zhvilluar strategji parandalimi dhe reagimi.

Anekset përfshijnë shabllone, burime shtesë dhe bibliografinë.

1. KUPTIMI I BRAKTISJES

PËRKUFIZIMET

Braktisja e shkollës zakonisht i referohet procesit të braktisjes së studimeve nga një nxënës përpara përfundimit të një cikli arsimor. Braktisja mund t'i referohet gjithashtu procesit të braktisjes së studimeve nga një nxënës në mes të dy cikleve të arsimit të detyrueshëm, si p.sh. mes arsimit fillor dhe të mesëm të ulët.

Në Bashkimin Evropian dhe në disa vende fqinje, termi 'largim i hershëm prej shkollës' përdoret gjithashtu në kontekstin e braktisjes. Ai i referohet indikatorit të Eurostat-it **Largimi i Hershëm nga Arsimi dhe Trajnimi** dhe përkufizohet si përqindja e personave të moshës 18 deri në 24 vjeç që kanë përfunduar maksimumi arsimin e mesëm të ulët dhe nuk janë të përfshirë në arsim ose trajnim të mëtejshëm, nga popullsia totale e moshës 18 deri në 24.¹



Nxënësit nuk duhet të llogariten si braktisës kur transferohen në një shkollë tjetër, migrojnë jashtë vendit ose ndërrojnë jetë.

Kur punojnë në parandalimin e braktisjes në nivel të shkollës, profesionistët ndonjëherë flasin për **fëmijët në rrezik të braktisjes**, domethënë fëmijët që *"janë të regjistruar në ndonjë dispozitë të detyrueshme ose pas detyrueshme, por që shfaqin faktorë rreziku ose shenja që tregojnë se mund ta braktisin shkollën, siç është niveli i lartë i mungesave"* (UNICEF, 2017).

Të rinjtë që **Nuk janë në Punësim, Arsim ose Trajnim** (NEET) janë të rinj që nuk janë të punësuar dhe nuk përfshihen në arsimim ose trajnim të mëtejshëm. Grup-mosha që mbulohet nga treguesi NEET ndryshon midis vendeve.²

PIKAT E RREZIKUT TË BRAKTISJES

Nxënësit janë veçanërisht të rrezikuar të braktisin shkollën kur:

- Ata **hyjnë në sistemin shkollor**, d.m.th. kur hyjnë për herë të parë në parashkollor ose klasën e parë, ose kur lëvizin në një vend tjetër dhe hyjnë në një sistem të ri shkollor;
- **Transferohen** nga një shkollë në tjetrën (rreziku për të mos u reregjistruar në shkollën e re)
- **Përfshihen** nga shkolla (rreziku të mos pranohen në një shkollë tjetër);
- Ata **kalojnë ndërmjet** cikleve të arsimit (p.sh. mes ciklit të mesëm të ulët dhe të lartë) **ose në vende të ndryshme pune dhe në kompani të ndryshme gjatë praktikave**;

¹ Më shumë informacion mbi Largimin e Hershëm nga Arsimi dhe Trajnimi dhe të dhënat e disponueshme të krahasueshme në të gjithë BE-në dhe vendet në hyrje mund të gjenden këtu: https://ec.europa.eu/eurostat/statistics-explained/index.php?title=Earlyleavers_from_education_and_training

² <https://ec.europa.eu/eurostat/statistics-explained/index.php?title=Glossary:NEET>

- Ata **tërhiqen nga shkolla** nga prindërit e tyre (zakonisht për shkak se prindërit planifikojnë të udhëtojnë jashtë vendit – megjithatë ndonjëherë udhëtimet nuk ndodhin dhe fëmijët nuk ri-registrohen kurrë në arsim).

Shkollat duhet të kenë mekanizma efektivë për të zbutur braktisjen e shkollës për këto pika specifike rreziku.

Reflektim

Sa është shkalla e braktisjes së shkollës në Shqipëri në nivele të ndryshme arsimore? Në shkollën tuaj?

PSE ËSHTË E RËNDËSISHME TË TRAJTOHET BRAKTISJA DHE LARGIMI I HERSHËM NË SHKOLLË?

Adresimi dhe reduktimi i braktisjes është i rëndësishëm për disa arsye:

- Arsimi është një e drejtë themelore e njeriut, për fëmijët dhe të rinjtë, edhe pas arsimit të detyrueshëm,
- Arsimi është baza për të rinjtë që të rriten, zhvillohen dhe fitojnë njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për të zhvilluar potencialin e tyre të plotë dhe për të jetuar si anëtarë produktivë të shoqërisë.

Braktisja e shkollës ka pasoja si për adoleshentët ashtu edhe për familjet e tyre, komunitetet dhe shoqërinë në tërësi.

Tabela 1: Pasojat e mundshme të braktisjes së shkollës

Të rinjtë	• Përrjashtimi social (p.sh. stigmatizimi, të mbeturit të pastrehë); • Rreziqet për mirëqenien (p.sh. vetëbesim i ulët) dhe për shëndetin (p.sh. obeziteti, depresioni); • Reduktimi i mundësive ekonomike dhe përjashtimi ekonomik (p.sh. punë me pagë të ulët, papunësi); • Reduktimi i mundësive sociale (p.sh. angazhimi në jetën e komunitetit ose pjesëmarrja politike); • Rrezik më i lartë i përfshirjes në aktivitete kriminale.
Familjet	• Konflikti ndërmjet anëtarëve të familjes për vendimin e braktisjes; • Humbja e të ardhurave në afat të gjatë e cila mund të ndikojë në pasurinë e përgjithshme të familjes; • Humbja e kapacitetit mbështetës të familjes në afat të gjatë pasi nxënësit që braktisin shkollën mund të kenë aftësi më të ulëta dhe më pak mundësi sociale; • Fëmijët e nxënësve që braktisin shkollën do të jenë në rrezik për një mirëqenie më të ulët (shëndet, mirëqenie socio-emocionale, pasuri) dhe do të kenë më shumë gjasa ta braktisin vetë.
Shoqëria	• Komunitete më pak kohezive; • Nivele më të larta të delikuentës dhe krimi; • Ulja e barazisë gjinore;

- Nivel më i ulët ekonomik për individët dhe komunitetet;
- Ngarkesë më të madhe në buxhetet e mirëqenies sociale, shëndetësisë dhe drejtësisë.

FAKTORËT E BRAKTISJES

Kategoritë e faktorëve të braktisjes

Braktisja e shkollës është zakonisht një proces dhe jo një vendim pas një ngjarjeje të vetme (ose të jashtëzakonshme).

Ky proces ndikohet nga një sërë faktorësh që ndërveprojnë në mënyra komplekse dhe dinamike.

Këta faktorë nuk lidhen vetëm me rrethanat individuale dhe familjare, por edhe me mjedisin shkollor, sistemin arsimor dhe të mirëqenies sociale në nivel makro.

Braktisja është shpesh rezultat i rrethanave individuale dhe familjare, të cilave strukturat dhe sistemet nuk janë në gjendje t'u përgjigjen ose t'i trajtojnë në kohë dhe në mënyrë të përshtatshme.

Për shembull, të kesh nevoja të veçanta arsimore nuk është arsyeja pse një nxënës braktis shkollën. Përkundrazi, kjo është për shkak se shkolla dhe shërbimet e tjera lokale janë të pa pajisura për të mbështetur në mënyrë adekuate të rinjtë me nevoja të veçanta arsimore dhe për të siguruar mbajtjen dhe suksesin e tyre në shkollë.

Ekzistojnë katër dimensionet kryesore të faktorëve të braktisjes dhe lënies së hershme të shkollës:




Figura 1: Nënkatëgoritë e faktorëve të braktisjes

Nënkatëgoritë e zakonshme të faktorëve të braktisjes në këto katër kategori kryesore janë si më poshtë:

Dimensioni	Nënkatëgoria	Shembuj të faktorëve të rrezikut
Adoleshenti	Mosha	Mosha më e madhe në krahasim me nxënësit e klasës dhe përsëritja e klasës Nxënësit më moshë më të madhe janë më të rrezikuar nga braktisja

Dimensioni	Nënkategoria	Shembuj të faktorëve të rrezikut
	Gjinia	Faktorët e rrezikut për djemtë dhe vajzat (<i>shih seksionin më poshtë</i>) Shtatzënia, martesë (e hershme)
	Shëndeti fizik dhe mendor	Sëmundje kronike ose kërcënuese për jetën Aftësia e kufizuar dhe pengesat në të mësuarit dhe zhvillimin Depresioni dhe çrregullimet e shëndetit mendor Vetëvlerësimi i ulët Abuzimi me substancat dhe varësitë Statusi i HIV-it ose jetesa me SIDA (veçanërisht për ata adoleshentë që kryejnë marrëdhënie seksuale me burra, persona transgjinjorë, adoleshentë që injektojnë drogë dhe punonjës seksi)
	Vendi	Largësia për/nga shkollë/a Ndryshimi i shpeshtë i vendbanimit ose shkollës Statusi i refugjatit/migrantit
	Gjuha	Gjuha amtare e ndryshme nga gjuha e mësimit
	Eksperiencat në arsim	Përrjashtim nga shkolla Bullizmi në shkollë
	Angazhimi akademik	Mungesa kronike Arritje të dobëta akademike Përsëritje Motivim i ulët Besim i ulët në aftësitë akademike Mungesa e vizionit për veten në të ardhmen
	Angazhimi social	Sjellje e dobët në shkollë Ndjenja e ulët e përkatësisë në shkollë Konflikti me ligjin
	Përvoja të tjera jetësore	Kujdestaria e hershme (prindërimi i hershëm ose kujdesi për të afërmit) Të rinjtë që punojnë Të mbijetuarit e dhunës dhe abuzimit
Familja	Demografia e familjes	Familje me një prind, familje me kryetarë gjyshërit Familje e madhe Minoritetet e marginalizuara etnike dhe gjuhësore Familjet me probleme të shëndetit mendor në familje
	Praktikat familjare	Historia e braktisjes së shkollës nga prindërit dhe vëllezërit e motrat Familje jofunksionale Neglizhimi, abuzimi ose shfrytëzimi i fëmijëve në familje

Dimensioni	Nënkategoria	Shembuj të faktorëve të rrezikut
Shkolla (dhe mjediset e praktikës në shkollë dhe biznes)	Burimet	Familje shumë të varfra, me status të ulët socio-ekonomik Familje të cënuara/të përjashtuara në shoqëri
	Lëvizshmëria	Familjet refugjate, emigrante Familje me lëvizshmëri të lartë/punë sezonale
	Struktura dhe organizimi	Drejtimi dhe menaxhimi i dobët i shkollës Mungesa e etikës gjithëpërfshirëse Klima e keqe shkollore, përjashtimi akademik dhe social Mungesa e lëndëve të duhura në AFP
	Burimet (financiare, njerëzore dhe materiale)	Shkollë e privuar Buxheti i kufizuar dhe autonomia për shpenzimet buxhetore Mungesa e mësuesve dhe personelit ndihmës (psikologë, punonjës social, etj.)
Faktorët sistematikë (niveli makro)	Politikat e shkollës	Rregulla dhe politika të dobëta të pjesëmarrjes dhe një sistem i dobët i menaxhimit të mungesave Politikat e përzgjedhjes për regjistrim dhe përsëritjes së vitit akademik
	Praktikat shkollore (aktivitetet, mbështetja e disponueshme dhe ndërveprimet në klasë dhe në shkollë)	Cilësi e ulët e arsimit Paragjykimet dhe diskriminimi prej mësuesve dhe stafit (veçanërisht në lidhje me përkatësinë etnike, gjinore, orientimin seksual, aftësinë e kufizuar) Mbështetje e dobët akademike dhe mësimore për personat me arritje të ulëta, mungesa e mbështetjes për mësimin e lëndëve Mbështetje e dobët sociale dhe emocionale për nxënësit, mbështetje e dobët e mirëqenies Marrëdhënie të dobëta ndërmjet personelit të shkollës (mësimdhënësve dhe stafit mbështetës) dhe nxënësve Marrëdhënie të dobëta shkollë-prindër Përfshirja/pjesëmarrja e kufizuar e prindërve nga grupet e rrezikut në aktivitetet dhe planifikimin e shkollës Vëmendje e ulët për zërin e nxënësve dhe pjesëmarrje e vogël e tyre Incidenca e lartë e dhunës ose bullizmit, përfshirë dhunën me bazë gjinore në shkollë
Faktorët sistematikë (niveli makro)	Legjislacioni, rregulloret	Pengesat administrative për regjistrim (letërnjoftimet, certifikatat e lindjes, lejet e qëndrimit, etj.) Legjislacioni diskriminues (gjinia, paaftësia, përkatësia etnike, fëmijët migrantë pa dokumente) Vullneti i ulët politik
	Politika arsimore, sociale dhe	Fokus i kufizuar i barazisë dhe financimit në arsim/politika sociale Rëndësia, efektiviteti dhe efikasiteti i kufizuar i mekanizmave të koordinimit dhe mbështetjes ndërsektoriale për të rinjtë në rrezik të mos-regjistrimit ose braktisjes së arsimit

Dimensioni	Nënkategoria	Shembuj të faktorëve të rrezikut
	politika të tjera përkatëse	
	Normat sociale	Vlerat e dobëta sociale rreth barazisë gjinore, përfshirjes sociale dhe mos-diskriminimit Normat diskriminuese gjinore
	Situata e vendit	Ekonomia Konflikte, fatkeqësi dhe kriza.

Tabela 2: Nënkategoritë e faktorëve të braktisjes

Burimi: Përshtatur nga Lyche (2010) dhe UNICEF (2017)

!	Jo të gjithë të rinjtë që paraqesin ose preken nga një ose më shumë nga këto karakteristika ose faktorë do të braktisin me domosdoshmëri shkollën. Mos i stigmatizoni apo etiketoni të rinjtë dhe familjet e tyre. Merrni parasysh faktorët mbrojtës që kontribuojnë në qëndrueshmërinë e të rinjve, si interesat, talentet, mbështetja dhe rrjetet shoqërore, kohezioni dhe mbështetja e fortë familjare, karakteri personal, pjekuria emocionale, motivimi dhe pika të tjera të forta.
Reflektim Cilët janë nxënësit më të marginalizuar dhe më vulnerabël në shkollën tuaj? Kush po braktis?	

Faktorët specifikë gjinor të rrezikut të braktisjes

Normat sociale dhe gjinore dhe stereotipet ndikojnë në ndërveprimet dhe të mësuarit në shkollë për djemtë dhe vajzat dhe ndikojnë ndryshe në procesin e braktisjes së tyre.

- Për shembull, vajzat mund të mos e kryejnë shkollën e mesme, sepse pritet që ato të kujdesen për vëllezërit e motrat më të vogla, të afërmit e sëmurë ose të martohen herët. Shtatzënia dhe prindërimi i hershëm mund të ndikojnë gjithashtu në pjesëmarrje.
- Djemtë mund të nisin punën dhe të kontribuojnë në të ardhurat e familjes, ose mund të përfshihen në sjellje të rrezikshme duke përfshirë abuzimin me substancat dhe aktivitetet kriminale.
-

Normat gjinore duhet të merren parasysh kur analizohen arsyet e braktisjes së shkollës nga një nxënës edhe kur zhvillohen zgjidhje për t'i parandaluar ata ta bëjnë këtë ose ta kthejnë nxënësin në shkollë.

Normat gjinore ndikojnë gjithashtu në mundësitë në të cilat djemtë dhe vajzat kanë akses.

Përkufizimet

Gjinia është një konstrukt socio-kulturor i cili formëson rolet e burrave dhe grave në një shoqëri të caktuar në një kohë të caktuar. Gjinia bazohet në dallimin biologjik midis burrave dhe grave (p.sh. lindja e fëmijëve...) mbi të cilat zhvillohen normat dhe vlerat shoqërore. Këto norma organizojnë marrëdhëniet shoqërore midis burrave dhe grave dhe rolet shoqërore të tyre në shoqëri.

Socializimi gjinor: Djemtë dhe vajzat socializohen që nga lindja në mjedisë që formojnë bindjet e tyre për normat gjinore. Ata përvetësojnë ose marrin norma gjinore, gjë që ndikon në mënyrën se si djemtë dhe vajzat veprojnë në shoqëri dhe ndërveprojnë me të tjerët.

Dhuna me bazë gjinore e lidhur me shkollën përkufizohet si “akte ose kërcënime të dhunës seksuale, fizike ose psikologjike që ndodhin brenda dhe rreth shkollave, të kryera si rezultat i normave dhe stereotipeve gjinore dhe të zbatuara nga dinamika e pabarabartë e pushtetit.” (UNESCO dhe UN Women, 2016)

	Djemtë	Vajzat
Biologjia		Shtatzënia në adoleshencë
Pritshmëritë akademike	Pritshmëri më të ulëta për djemtë në shkollë (p.sh. për të mësuarit, për sjelljen) Të dhënat nga PISA 2018 tregojnë një hendek prej 20% në Shqipëri midis përqindjes së djemve dhe vajzave mes atyre me arritje të ulëta në lexim në disavantazh të djemve. Trajtimi më i ashpër i djemve në shkollë dhe në shtëpi	Pritshmëri më të larta për vajzat në disa lëndë Pritshmëri më të larta për sjelljen
Presion për t'iu përshtatur normave gjinore	Krijimi i të ardhurave ose presioni i bashkëmoshatarëve në arritjet akademike Ndikimi i modeleve negative tek djemtë dhe mungesa e modeleve pozitive në shkolla dhe komunitete	Pritshmëritë shoqërore të martesës dhe riprodhimit Martesa e hershme Përgjegjësitë për punët e shtëpisë Përgjegjësitë për t'u kujdesur për vëllezërit e motrat më të vegjël
Socio-emocional	Ndjeshmëria e djemve ndaj qëndrimit negativ të mësuesve Rezistencë e ulët ndaj dështimit akademik	Vetëvlerësim i ulët Mungesa e besimit dhe ankthi për detyrat e shtëpisë dhe testet
Autonomia	Djemtë vënë në pikëpyetje mungesën e zbatimit dhe rëndësisë së mësimit të bazuar në shkollë (në veçanti në shkollën e mesme) dhe vlerën ekonomike të arsimit	Frika e prindërve për vajzat që studiojnë larg komunitetit (gjë që kufizon aksesin në arsimin e mesëm dhe arsimin dhe formimin profesional (AFP))

	Djemtë	Vajzat
Dhuna me bazë gjinore në shkollë	Më shumë gjasa për t'u ndëshkuar (përfshirë ndëshkimin fizik aty ku ekziston) dhe për t'u përballur me diskriminimin e orientimit seksual, siç është homofobia	Më shumë gjasa se djemtë të përjetojnë bullizëm psikologjik, bullizëm kibernetik, dhunë dhe ngacmim seksual
Mundësitë ekonomike	Dëshira e djemve për të filluar karrierën herët, për të fituar para dhe vendosmëria për sukses Perspektiva më të mira punësimi se vajzat në sektorët formal dhe informal	Mundësi më të ulëta ekonomike dhe shpesh në sektorë me performancë të dobët (kujdes, parukeri) ose sektorë që sjellin fitime më të ulëta ekonomike (sektorët socialë) Akses më i ulët në teknologji
Çështje lidhen punën që me	Vështirësi që lidhen me integrimin në biznes për arsye të ndryshme	Punë të vështira që psikologjikisht apo fizikisht mund të mos i përballojnë

Tabela 3: Faktorët që ndikojnë në edukimin e djemve dhe vajzave

Burimi: Harrington (2005) *UNGEI and the Commonwealth Education Hub* (2016), Borgna dhe Struffolino (2017), UNESCO dhe UN Women (2016)

Reflektim

Me cilat norma gjinore pritet të përputhen djemtë dhe vajzat adoleshente në Shqipëri? Sa të ndryshme janë këto norma gjinore në zonat rurale dhe urbane? Statuset socio-ekonomike?


2. SISTEMET E PARALAJMËRIMIT TË HERSHËM PËR PARANDALIMIN E BRAKTISJES

QASJA E TË GJITHË SHKOLLËS NDAJ PARANDALIMIT TË BRAKTISJES

Parandalimi i braktisjes nuk është një punë shtesë. Është pjesë e përpjekjes së përgjithshme të shkollës për të mbështetur zhvillimin holistik të nxënësve dhe për të siguruar që ata të jenë aktiv, të mësojnë, të rriten dhe të zhvillohen.

Qasjet efektive të parandalimit të braktisjes në nivel shkolle miratojnë **një strategji me dy drejtime**:

1. Një qasje e tërë shkollës, dhe
2. Mbështetje specifike për rastet individuale të nxënësve në rrezik braktisjeje



Grafiku 2: Qasje gjithëpërfshirëse për parandalimin e braktisjes

1. Një qasje e të gjithë shkollës nënkupton që:

- Parandalimi i braktisjes së shkollës është një proces i vazhdueshëm që kërkon përfshirje dhe që kontribuon në përpjekjet e përgjithshme të shkollës për të përmirësuar cilësinë e arsimit dhe gjithëpërfshirjen për të gjithë fëmijët. Nuk është një “projekt” apo një iniciativë e pavarur e kufizuar në kohë dhe e shkëputur nga veprimtaria e rregullt e shkollës.
- Parandalimi i braktisjes së shkollës përfshin mjedisin dhe detyrat e të gjithë shkollës: politikat dhe praktikën e shkollës, kapaciteti i stafit dhe zhvillimi profesional, mësimdhënia, mbështetja e mirëqenies socio-emocionale, strategjitë dhe praktikën e bazuara në prova dhe monitorimi dhe mbledhja e të dhënave për të siguruar që proceset dhe aktivitetet që kanë të bëjnë me parandalimin e braktisjes sjellin një ndryshim pozitiv.
- Një gamë e gjerë palësh të interesuara në shkollë dhe jashtë shkollës marrin pjesë në aktivitetet e parandalimit të braktisjes, d.m.th. jo vetëm mësuesit dhe stafi i shkollës, por edhe stafi tjetër si psikologët, punonjësit social, prindërit, nxënësit, komunitetet dhe agjencitë përkatëse të jashtme, shërbimet lokale, punëdhënësit, bizneset lokale dhe shoqëria civile.

2. Mbështetja specifike për individin/grupet e nxënësve i referohet proceseve dhe ndërhyrjeve që ndërmerren për të parandaluar ose për t’iu përgjigjur braktisjes kur është identifikuar një rrezik.

Parandalimi efektiv i braktisjes së shkollës kërkon që shkollat të zbatojnë të dyja strategjitë pasi secila prej tyre është kritike për parandalimin e braktisjes së shkollës dhe për pjesëmarrjen, mësimin, mirëqenien dhe suksesin e të gjithë nxënësve në shkollë.

SISTEMET E PARALAJMËRIMIT TË HERSHËM PËR PARANDALIMIN E BRAKTISJES

Ky seksion shpjegon se si të zhvilloni Sistemin e Paralajmërimit të Hershëm për parandalimin e braktisjes në shkollën tuaj.

Një SPH është një mjet që synon të identifikojë nxënësit në rrezik të braktisjes së shkollës, bazuar në praninë e 'flamujve të kuq': faktorë specifikë që kontribuojnë në braktisjen e shkollës. Pas identifikimit të tyre, SPH më pas i mbështet ata që të qëndrojnë në shkollë përmes strategjive dhe ndërhyrjeve për të përmbushur nevojat e tyre specifike. Është **një sistem** (d.m.th. një sekuencë procedurash që janë menduar dhe njohur, të cilat ndahen me gjithë stafin e interesuar) që u mundëson shkollave ose autoriteteve arsimore të njohin një paralajmërim të **flamurit të kuq** në një fazë të hershme – përpara se nxënësi të braktisë shkollën dhe mjaft herët për të vendosur mbështetjen e duhur për t'i mbajtur ata në shkollë). Shkurtimisht, një SPH është një sistem **që u mundëson shkollave dhe autoriteteve arsimore të identifikojnë nxënësit me nevoja specifike dhe t'i mbështesin ata në kohën e mënyrën e duhur**.

Një SPH përfshin pesë hapa të thjeshtë për të identifikuar nxënësit në rrezik për të mos u kthyer në shkollë dhe për të mbështetur (ri)integrimin e tyre.




Figura 2: Sistemet e Paralajmërimit të Hershëm: pesë hapat

Hapi 1: Treguesit

Hapi i parë në çdo SPH është zgjedhja e treguesve që do të identifikojnë nxënësit në rrezik për të braktisur shkollën. Këta tregues bazohen në 'parashikuesit' ose 'flamujt e kuq' për braktisjen e shkollës, të njohur në kontekstin shqiptar.

Në hapin 1, shkollat:

- ngrenë një grup të stafit të shkollës (stafi drejtues, mësuesit dhe stafi mbështetës) për të vendosur tregues për SPH;
- identifikojnë dhe i japin rëndësi faktorëve kryesorë të rrezikut dhe parashikuesve të braktisjes së shkollës, bazuar në provat kontekstuale;

- rishikojnë treguesit standard të propozuar nga QENDRO për çdo parashikues dhe shtojnë deri në 2 faktorë rreziku shtesë bazuar në kontekstin e tyre;
- konfirmojnë burimet e të dhënave dhe mënyrën se si do të mblidhen të dhënat;
- marrin parasysh përshtatjen e sistemit për ta bërë SPH mjaft të ndjeshëm ndaj rreziqeve të braktisjes në kontekstin e shkollës;
- rishikojnë dhe bien dakord për pragjet mbi të cilat nxënësit do të identifikohen 'në rrezik' ose 'në rrezik të lartë' për të braktisur shkollën.

Treguesit

Rekomandohet që shkollat të përdorin **tregues thelbësor të përbashkët** për SPH-në e tyre, bazuar në 4 parashikuesit kryesorë të braktisjes së shkollës në arsimin e mesëm të lartë dhe atë profesional:

1. Mungesa
2. Arritje të ulëta akademike
3. Sjellja e dobët
4. Drejtimi/orientimi joadekuat arsimor

Duhet të merren parasysh faktorë të tjerë të rrezikut për të identifikuar ata nxënës që janë në rrezik të braktisjes:

- a. Mosha e madhe
- b. Sëmundje ose paaftësi
- c. Rrethanat specifike personale
- d. Rrethanat specifike familjare
- e. Vetëbesimi i ulët
- f. Ndjenja e ulët e përkatësisë
- g. Përjetimi i bullizmit

Fusha	E përgjithshme	Përshtatja me kontekstin shqiptar	Metoda
Shenjat e paralajmërimit të hershëm			
Mungesa	Numri i mungesave të pajustificuara	Nxënësi ka X numër mungesash të pajustificuara në muaj	Të dhënat sipas çdo shkolle profesionale
Arritje akademike	Nota të dobëta Përsëritje	Nxënësi ka X notë dhe/ose Nxënësi e ka përsëritur klasën dy ose më shumë herë	Të dhënat sipas çdo shkolle profesionale
Sjellja	Sjellje e dobët/përçarëse në shkollë Përgjashtimi i mëparshëm	<i>Si të vlerësohet sjellja?</i> ose Së paku një paralajmërim për përgjashtim nga shkolla që nga regjistrimi në shkollën e mesme	Të dhënat sipas çdo shkolle profesionale
Rrugat e edukimit	Drejtimi jo i duhur arsimor	Nxënësi nuk është në drejtimin arsimor prej zgjedhjes së tij ose Nxënësi e kupton mungesën e interesit për drejtimin aktual arsimor	Pyetësor për nxënësin

Fusha	E përgjithshmja	Përshtatja me kontekstin shqiptar	Metoda
Faktorët rëndues të rrezikut			
Mosha	Mbi 2 vite ose më shumë	N/A	Të dhënat e shkollës
Sëmundje ose paaftësi	Sëmundje kronike ose paaftësi që ndikojnë në arsim	N/A	Të dhënat e shkollës
Rrethanat personale	- Përgjegjësitë rreth kujdesit - Përgjegjësitë e punës - Shkelës ligji - Shqetësime për mbrojtjen e fëmijës - Shtatzënia/prindërimi - I/E martuar/në rrezik për t'u martuar - Historia e mëparshme e braktisjes	<i>Nxënësi ka përgjegjësi të konsiderueshme për kujdesjeje për vëllezërit e motrat, prindërit ose të afërmit</i> <i>Nxënësi punon për të fituar jetesën</i> <i>Nxënësi ka qenë më parë në konflikt me ligjin</i> <i>Nxënësjë është shtatzënë/ prind</i> <i>Nxënësi është i/e martuar/në rrezik për t'u martuar</i> <i>Nxënësi ka histori të mëparshme braktisjeje</i>	Të dhënat e shkollës dhe/ose pyetësori për nxënësin Të dhëna nga shkolla e mëparshme e nxënësit (për rrezikun dhe historinë e braktisjes)
Rrethanat familjare	- Statusi i ulët socio-ekonomik i familjeve/shkalla e varfërisë - Distanca e vendbanimit dhe transporti - Mungesa e mbështetjes familjare	<i>Familja e nxënësit ka statusin më të ulët të të ardhurave</i> <i>Nxënësi përballë me sfida të mëdha transporti për të ndjekur shkollën</i> <i>Nxënësi nuk mbështetet nga familja për të përfunduar arsimin</i>	Të dhënat e shkollës dhe/ose pyetësori për nxënësin
Vetëbesimi	Besim i ulët në aftësitë akademike Mungesa e vizionit për veten në të ardhmen	<i>Shihni pyetësorin për nxënësin në aneksin më poshtë</i> <i>Shihni pyetësorin për mësuesin në aneksin më poshtë</i>	Pyetësori për nxënësin Vlerësimi i mësuesve?
Përkatësia	Ndjenja e përkatësisë në shkollë	<i>Shihni pyetësorin për nxënësin në aneksin më poshtë</i> <i>Shihni pyetësorin për mësuesin në aneksin më poshtë</i>	Pyetësori për nxënësin Vlerësimi i mësuesve?
Bullizmi	Përjetimi i bullizmit në shkollë	Nxënësi ka përjetuar bullizëm në shkollë në X muajt e fundit	Të dhënat e shkollës dhe/ose pyetësori për nxënësin

Fusha	E përgjithshmja	Përshtatja me kontekstin shqiptar	Metoda
Faktor shtesë rreziku bazuar në kontekstin e shkollës	Vështirësi për tu integruar në praktikat profesionale në shkollë	Punë jashtë kontekstit të moshës apo mos njohja e mjedisit të punës	Të dhënat e shkollës dhe/ose pyetësori për nxënësin nga praktikatat në biznes
Faktor shtesë rreziku bazuar në kontekstin e shkollës	Vështirësi për tu integruar në praktikat profesionale në biznes	Punë e vështirë për moshën apo mos njohja e mjedisit të punës	Të dhënat e shkollës dhe/ose pyetësori për nxënësin nga praktikatat në biznes

ANEKS 1. PYETËSOR PËR PIKAT E FORTA DHE VËSHTIRËSITË E ADOLESHENTIT

Për çdo pohim, ju lutemi shënoni kutinë për Jo e vërtetë, Disi e vërtetë ose Mëse e vërtetë. Do të na ndihmonte nëse do t'i përgjigjeshit të gjithë pohimeve, edhe nëse nuk jeni absolutisht i sigurt ose pohimi duket i çuditshëm! Ju lutemi, jepni përgjigjet tuaja në bazë të sjelljes së adoleshentit gjatë gjatshë muajve të fundit ose të këtij viti shkollor.

Emri i Adolehentit: _____

Ditëlindja: ____ / ____ / ____

☐ Mashkull / ☐ Femër

	Jo e Vërtetë	Mëse e Vërtetë	Disi e Vërtetë
Merr parasysh ndjenjat e të tjerëve	☐	☐	☐
I shqetësuar, tepër aktiv, nuk mund të qëndrojë pa lëvizur për një kohë të gjatë	☐	☐	☐
Shpesh ankohet për dhimbje koke, dhimbje stomaku ose sëmundje	☐	☐	☐
Ndan me lehtësi gjëra me të tjerë (ushqim, mjete shkollore, etj).	☐	☐	☐
Shpesh shfaq nervozizëm ose temperament të fortë	☐	☐	☐
Më tepër rri i vetmuar	☐	☐	☐
Në përgjithësi i bindur, bën atë që i kërkohet	☐	☐	☐
Duket i shqetësuar	☐	☐	☐
Ndihmon nëse dikush lëndohet, mërzitët ose ndihet i sëmurë	☐	☐	☐
Vazhdimisht i pavëmendshëm, në lëvizje	☐	☐	☐
Ka të paktën një shok të ngushtë	☐	☐	☐
Shpesh krijon debate me të tjerët ose bullizon	☐	☐	☐

	Jo e Vërtetë	Mëse e Vërtetë	Disi e Vërtetë
Shpesh i pakënaqur, i mërzhitur	☐	☐	☐
Në përgjithësi, i pëlqyer nga të tjerët	☐	☐	☐
Shpërqëndrohet lehtësisht	☐	☐	☐
Nervoz në situata të reja, humbet lehtësisht besimin	☐	☐	☐
Është i sjellshëm	☐	☐	☐
Shpesh gënjen ose kopjon	☐	☐	☐
Bullizohet nga të tjerët	☐	☐	☐
Ofrohet si vullnetar për të ndihmuar të tjerët (mësuesit, nxënësit e tjerë)	☐	☐	☐
I mendon gjërat përpara se të veprojë	☐	☐	☐
Vjedh nga shtëpia, shkolla apo diku tjetër	☐	☐	☐
Shkon më mirë me të rriturit sesa me nxënësit e tjerë	☐	☐	☐
I frikësuar, trembet lehtësisht	☐	☐	☐
I mbaron detyrat deri në fund, vëmendje e mirë	☐	☐	☐

Firma: _____

Data: ____/____/____

Prind/Mësues/Tjetër (ju lutem, specifikoni:) _____

ANEKS 2. SHKALLA E MIRËQENIES SË ADOLESHENTIT

Emri i Adoleshentit:

Data:

Pyetësor i mirëqenies së adoleshentit

Ky formular është krijuar në mënyrë që të mund të tregoni se si jeni ndjerë në ditët e fundit.

Ju lutemi lexoni çdo pohim dhe rrethoni përgjigjen që tregon më së miri se si ndiheni ose jeni ndjerë në ditët e fundit.

		Shumicën e kohës	Ndonjëherë	Asnjëherë
1	I pres gjërat me kënaqësi, si më parë			
2	Unë fle shumë mirë			
3	Më vjen të qaj			
4	Më pëlqen të dal			
5	Më vjen të largohem nga shtëpia			
6	Kam dhimbje/ngërçe			
7	Unë kam shumë energji			
8	Më pëlqen ushqimi			
9	Unë mund të mbroj veten time			
10	Unë mendoj se jeta nuk ia vlen të jetohet			
11	Unë jam i/e mirë në gjërat që bëj			
12	Më pëlqejnë gjërat që bëj si dikur			
13	Më pëlqen të flas me miqtë dhe familjen time			
14	Kam ëndrra të tmerrshme			
15	Ndihem shumë i/e vetmuar			
16	Unë gëzohem lehtësisht			
17	Ndihem aq i/e trishtuar sa mezi e duroj			
18	Ndihem sikur nuk kam çfarë të bëj			

Pikëzimi

- Përgjigjet për secilën pyetje vlerësohen me 0, 1 ose 2. Mënyra se si shënohen vlerësimet varet nga natyra e pohimit që po përgjigjet si dhe nga përgjigja. 0 do të thotë që përgjigja nuk tregon asnjë shqetësim, 1 shqetësim të mundshëm dhe 2 që i riu tregon pakënaqësi ose vetëbesim të ulët në lidhje me atë pohim.
- Një rezultat prej 13 ose më shumë është gjetur se tregon mundësinë e një çrregullimi depresiv. Diskutimi me të riun dhe informacioni nga burime të tjera do të jetë i nevojshëm për të vendosur një diagnozë të saktë. Do të ketë disa që shënojnë rezultate të larta, por që në konsideratë të kujdesshme nuk gjykohen se kanë një çrregullim depresiv, dhe të tjerë që kanë rezultate të ulëta që kanë një të tillë. **Nëse adoleshenti shpreh ide për vetëvrasje ose planifikon të dëmtojë veten, duhet të ndërmerren veprime urgjente.**
- Në shumicën e rasteve mënyra se si një i ri u përgjigjet pyetjeve të ndryshme do të jetë po aq e rëndësishme dhe po aq e vlefshme sa çdo pikë, sepse ato mund të japin një pasqyrë të nevojave të adoleshentit. Përgjigja e vetëm një pyetjeje mund të japë mundësinë për të kuptuar këndvështrimin e tyre. **Përdoreni këtë mjet për të nxitur diskutimin**

Pyetja	0	1	2
--------	---	---	---

Ndërlidhja me shkollat e mëparshme të nxënësve për të marrë informacion mbi rreziqet specifike dhe historinë e mëparshme të braktisjes është e rëndësishme, veçanërisht për nxënësit që hyjnë në klasën e 10. Kur një nxënës konsiderohet në rrezik të braktisjes së arsimit të detyrueshëm, ata duhet të konsiderohen të rrezikuar gjatë kalimit nga klasa 9 deri në klasën e 10 dhe gjithashtu kur hyjnë në arsimin e mesëm të lartë të përgjithshëm ose profesional.

Niveli i rrezikut

Çdo nxënës që shfaq një nga Shenjat e Paralajmërimit të Hershëm mund të braktisë shkollën, veçanërisht kur ato rëndohen nga faktorë të tjerë rreziku.

Kryerja e një vlerësimi bazuar në treguesit kryesorë është një mënyrë për të identifikuar nxënësit në rrezik të braktisjes, por nuk është një teori ekzakte. Përveç një vlerësimi të automatizuar, diskutimet ndërmjet stafit të shkollës me nxënësin dhe familjen e tyre, kur është e mundur, do t'i ndihmojnë shkollat të rregullojnë mirë listën e tyre të nxënësve në rrezik dhe/ose në rrezik të lartë të braktisjes.

Të kesh më shumë shenja rreziku se një person tjetër për të braktisur shkollën nuk do të thotë se dikush do të braktisë domosdoshmërisht. Në mënyrë të ngjashme, mos shfaqja e shenjave të paralajmërimit të hershëm nuk do të thotë se dikush nuk do ta braktisë shkollën. Ndërsa nxënësit mund të hasin faktorë që do të kontribuojnë në mosangazhimin në shkollë, ata gjithashtu mund të shfaqin faktorë 'mbrojtës' që do të kontribuojnë në ndjekjen dhe përfundimin e shkollës. Faktorët mbrojtës variojnë nga tiparet e personalitetit, këndvështrimi për jetën, mbështetja e familjes/rrjetet shoqërore dhe aftësitë socio-emocionale që kontribuojnë në aftësinë e adoleshentit për t'u përshtatur.

Faktorët e rrezikut	Niveli i rrezikut
Mungesat ose 2 Shenja Paralajmëruese të Hershme	Në rrezik të braktisjes
Tre ose më shumë Faktorë Rëndues	Në rrezik të braktisjes
Mungesat ose 2 Shenja Paralajmëruese të Hershme + 1 ose më shumë Faktorë Rëndues	Në rrezik të lartë të braktisjes

Tabela 4: Faktorët e rrezikut dhe niveli i rrezikut për braktisjen e shkollës

Hapi 2: Identifikimi i nxënësve në rrezik të braktisjes

Pasi të përzgjidhen treguesit, mund të bëhet identifikimi i nxënësve në rrezik braktisjeje.

Në hapin 2, shkollat:

- përcaktojnë se si do të mbledhen dhe regjistrohen të dhënat për secilin tregues (nga kush dhe si)
- zhvillojnë tabela dhe mjete të tjera për të mbledhur dhe analizuar të dhënat
- hartojnë rregullisht lista të nxënësve në rrezik dhe/ose në rrezik të lartë për t'u braktisur
- sigurojnë që të dhënat personale janë të mbrojtura.

Një SPH funksionon më mirë kur i përmbahet **një qasjeje të të gjithë shkollës**: i gjithë stafi i shkollës duhet të jetë i vetëdijshëm për ndikimin negativ të braktisjes, faktorët e mundshëm të braktisjes dhe shenjat e saj, dhe llojet e ndërhyrjeve ndaj braktisjes që janë të menaxhueshme brenda shkollës ose të disponueshme jashtë saj.

Për më tepër, shkollat duhet të lehtësojnë procesin SPH duke automatizuar disa mbledhje të të dhënave dhe duke kombinuar të dhëna nga burime të ndryshme për pjesëmarrjen, arritjet akademike dhe sjelljen. Kjo bëhet më së miri nga ekipi drejtues i shkollës.

Përgjegjësitë

Për projektin QENDRO, çdo shkollë do të **organizojë një Ekip për Parandalimin e Braktisjes** së shkollës, i përbërë nga: drejtori dhe zëvendësdrejtori i shkollës, të gjithë mësuesit dhe stafi mbështetës (psikologët/këshilluesit ose punonjësit social të shkollës).

Ekipi do të mbikëqyrë identifikimin dhe monitorimin e nxënësve në rrezik të braktisjes. Mësues të tjerë do të marrin pjesë në aktivitetet e Ekipit kur nxënësit për të cilët janë përgjegjës identifikohen në rrezik të braktisjes.

Ekipi i Parandalimit të Braktisjes do të përcaktojë se si do të mbledhen dhe regjistrohen të dhënat për secilin tregues dhe do të përgatisë (ose rregullojë) tabelat dhe mjetet e mbledhjes së të dhënave.

Procesi

Do të duhet të finalizohet një proces për identifikimin e nxënësve në rrezik braktisjeje, duke përfshirë:

1. Frekuenca e mbledhjes së të dhënave, analiza e të dhënave dhe përditësimi i listës së nxënësve në rrezik braktisjeje.

Ndërkohë që disa të dhëna duhet të mblidhen dhe analizohen në mënyrë rutinore, të tilla si mungesat, arritjet akademike dhe sjellja për t'u pasuruar në procesin SPH, të dhëna të tjera mund të mblidhen vetëm kur vihen re (p.sh. një ndryshim në rrethanat personale të një nxënësi) ose në një të dhënë në kohë gjatë vitit shkollor, zakonisht gjatë 3 muajve të parë të vitit akademik (p.sh. pyetësorët e nxënësve, për të identifikuar vetëbesimin e tyre, aftësinë për të parë veten në të ardhmen, ndjenjën e përkatësisë në shkollë, mbështetjen e përgjithshme në shtëpi, dhe ndoshta edhe disa rrethana personale).

Kur procesi vonohet, sistemi mund të mos i identifikojë nxënësit 'aq herët sa duhet' për të parandaluar braktisjen e tyre. Prandaj, koha e identifikimit dhe ndërhyrjeve të reagimit është **kritike** në zbatimin e një SPH.

2. Një protokoll që shpjegon se kush duhet të bëjë çfarë, kur dhe si për identifikimin e nxënësve në rrezik të braktisjes.

Reflektim

1. A ka shkolla juaj një SPH?
2. Cilat burime të dhënash të disponueshme mund të përdorë shkolla juaj për të marrë informacion në lidhje me treguesit e braktisjes së SPH?
3. Çfarë kontribuojnë (ose mund të kontribuojnë) stafi dhe ekipet e shkollës, si psikologët dhe ekipet e parandalimit, për të identifikuar nxënësit në rrezik për të braktisur shkollën tuaj?

Hapi 3: Vlerësimi i nevojave të nxënësve

Treguesit e përdorur në SPH mundësojnë identifikimin e nxënësve në rrezik, por më shumë informacion është i nevojshëm që stafi i shkollës të kuptojë kompleksitetin e arsyeve që qëndrojnë pas shenjave të rrezikut të braktisjes së shkollës dhe të identifikojë ndërhyrjet përkatëse parandaluese dhe ofrimin e mbështetjes.

Në hapin 3, shkollat:

- krijojnë një qasje për të vlerësuar nevojat e ndryshme të nxënësve në rrezik të braktisjes
- diskutojnë me nxënësit dhe familjen situatën e tyre, për të hedhur dritë mbi shenjat e dukshme të rrezikut të braktisjes dhe për të folur për masat për përmirësimin e situatës
- kanë diskutime me palë të tjera të interesuara
- përdorin informacionin e disponueshëm për të zgjedhur masat për të mbështetur nxënësit në rrezik për braktisje
- sigurojnë që informacioni sensitiv të trajtohet dhe të mbrohet siç duhet.

Pasi Ekipi për Parandalimin e Braktisjes së Shkollës të ketë identifikuar nxënësit në rrezik të braktisjes së shkollës dhe sa herë që një nxënës i ri identifikohet në rrezik, do të bëhet një vlerësim i nevojave për të vlerësuar nevojat e nxënësve dhe për të identifikuar masat parandaluese dhe mbështetëse.

Rreziqet e braktisjes dhe arsyet për mungesat dhe mosangazhimin mund të jenë komplekse dhe të perceptohen ndryshe nga palë të ndryshme të interesuara. Prandaj, mbledhja dhe analizimi i informacionit nga disa burime është thelbësor për të kuptuar këto këndvështrime të ndryshme. Kur punoni me familje, merrni parasysh perceptimet e ndryshme të prindërve.




Figura 3: Perspektivat e aktorëve të ndryshëm mbi faktorët e rrezikut të braktisjes

Përgjegjësitë:

Për çdo nxënës në rrezik, Ekipi për Parandalimin e Braktisjes së Shkollës do të hartojë një plan veprimi për të kryer një vlerësim të nevojave.

Stafi i shkollës mund të jetë në gjendje të mirë për të biseduar me nxënësit dhe për të vlerësuar nevojat e tyre: mësuesi kujdestar, psikologu i shkollës, mësuesi i orientimit për karrierën, punonjësi social në shkollë, një anëtar i stafit drejtues me përgjegjësi për nxënësit, ose një mësues i besuar nga nxënësi. Një kombinim i të gjithë këtyre mund të jetë i dobishëm, në varësi të situatës së nxënësit dhe burimeve të shkollës.

Procesi:

Qëllimi i vlerësimit të nevojave është të kuptojë tre çështje:

1. Cilat janë pengesat për ndjekjen e shkollës dhe orëve mësimore?
2. Çfarë mund të bëhet për të ndihmuar nxënësin të riangazhohet në mësim dhe të kthehet/të qëndrojë në shkollë? (nga shkolla apo palë të tjera të interesuara duke përfshirë familjet, bashkëmoshatarët, shërbimet e jashtme)?
3. A është nxënësi i rrezikuar nga neglizhenca, abuzimi ose dhuna dhe duhet t'i referohet shërbimeve të mbrojtjes së fëmijëve (nën moshën 18 vjeç) ose shërbimeve sociale dhe rinore (kur është mbi 18 vjeç)?

Gjatë fazës së vlerësimit të nevojave, stafi i shkollës do të hulumtojë rreth:

- Faktorët themelorë që ndikojnë në frekuentimin e dobët, performancën e ulët akademike, sjelljen e dobët dhe si ndikojnë rrethanat personale ose familjare në arsimimin e nxënësit.
- Pikat e forta dhe interesat e nxënësit, si dhe faktorët mbrojtës që do të rrisin aftësinë e tij për t'u përshtatur, të cilat duhen risjellë në vëmendje për të ulur rrezikun e braktisjes.

Vlerësimi i nevojave zakonisht përfshin:

- Diskutim me nxënësin dhe familjen për të identifikuar sfidat dhe barrierat me të cilat përballen nxënësit dhe për të rënë dakord për masat për përmirësimin e situatës;
- Mundësisht diskutime shtesë me stafin dhe mësuesit e tjerë të shkollës, palët e jashtme të interesuara (p.sh. shërbimet sociale) ose anëtarët e familjes, shokët e nxënësve për të identifikuar masat dhe rrjetet mbështetëse.

- Grumbullimi i informacionit shtesë kur është e nevojshme nga të dhënat e shkollës për nxënësin, ose pyetësorët, testet psikometrike.

Diskutimet joformale me nxënësit dhe familjet dhe vlerësimet e nevojave janë më mirë të mbahen të thjeshta.

Shembuj të fushave të diskutimit për vlerësimin e nevojave mund të gjenden në Aneks.

Mjetet:

Mjetet e vlerësimit të nevojave mund të përfshijnë shabllone intervistash për nxënësit dhe familjet, dhe pyetësorët e nxënësve ose testet psikometrike.

Më poshtë janë llojet e informacionit për të mbledhur gjatë një vlerësimi të nevojave.

Fushat	Pikat kryesore
1. Karakteristikat në shtëpi	• Anëtarët e shtëpisë • Përgjegjësitë e kujdesit në familje (kush ka përgjegjësi mbi nxënësin, kush kujdeset për nxënësin, kush kujdeset për fëmijët e tjerë të familjes)
2. Barrierat kryesore për ndjekjen e shkollës (d.m.th. arsyt e mungesave)	• Rrethanat personale • Rrethanat familjare • Rrethanat e lidhura me shkollën • Rrethanat e lidhura me komunitetin • Rrethanat e lidhura me punën në biznes
3. Problemet kryesore me të cilat përballlet familja, si p.sh. + PËRPARËSITË E FORTA të familjes	• Strehimi, punësimi, financat • Diskriminimi dhe marrëdhëniet shoqërore • Marrëdhëniet familjare • Aftësitë e prindërimit • Përgjegjësitë e kujdesit • Ngjarje të rëndësishme që ndikojnë në familje • Sigurimi i një mjedisi mbështetës për fëmijën për të mësuar • Ndikimi i COVID-19
4. Problemet kryesore me të cilat përballlet nxënësi, si p.sh. + PËRPARËSITË E FORTA të nxënësit	• Shëndeti fizik dhe mendor • Ndikimi i COVID-19 dhe ndërprerja e arsimit • Marrëdhëniet familjare dhe shoqërore • Arsimimi dhe aspiratat e jetës dhe karrierës • Përgjegjësitë e kujdesit • Përvoja negative në shkollë • Diskriminimi • Ngjarje të rëndësishme që kanë ndikuar te nxënësi • Fushat e interesit, talentet
5. Mënyrat për të mbajtur nxënësin në shkollë, duke përfshirë:	• Veprimet që duhen ndërmarrë nga familja • Veprimet që duhen ndërmarrë nga nxënësi • Veprimet që duhen ndërmarrë nga shkolla • Veprimet që duhen ndërmarrë nga institucione specifike për të mbështetur fëmijën (dhe familjen kur është e nevojshme) për të

	qëndruar në shkollë, p.sh. shërbimet sociale, komuna, ndërmjetësuesit, OJQ-të, punëdhënësi, këshilluesit e punës, etj.) • Veprimet që duhen ndërmarrë nga palët e tjera të interesit (rrjeti më i gjerë mbështetës), p.sh. të afërmit e familjes, shokët e klasës, anëtarët e komunitetit, bizneset..., etj.
--	---

Tabela 5: Llojet e informacionit për të mbledhur gjatë një vlerësimi të nevojave

Burimi: Përshtatur nga UNICEF Bullgaria dhe Ministria e Arsimit dhe Shkencës (2018)

Reflektim

1. Cilat mjete për vlerësimin e nevojave janë në dispozicion në shkollën tuaj, nëse ka? Cilat janë pikat e forta dhe të dobëta të tyre?

Referimi i nxënësve në shërbime mbështetëse të jashtme

Ka raste kur shkollat do të kenë vënë re diçka te nxënësit dhe/ose familjet e tyre që do të justifikonte një referim tek një agjenci e jashtme, si shërbimet sociale, shërbimi i mbrojtjes së fëmijëve ose agjenci të tjera mbështetëse, për shembull në rast të një problemi të shëndetit mendor.

Është thelbësore që shkollat të kuptojnë se kur dhe ku t'i referojnë nxënësit, në mënyrë që situatat të mos përshkallëzohen dhe nevojat për mirëqenien e nxënësve të adresohen në kohën e duhur.

Ka lloje të ndryshme referimesh:

- **Abuzim, dhunë dhe neglizhencë** - Stafi i shkollës që zbulon ose ka dyshime për dhunë ndaj fëmijëve (neglizhencë, dhunë, abuzim duke përfshirë abuzimin seksual) zakonisht vendoset nën detyrimin për të njoftuar një pikë qendrore për mbrojtjen e fëmijëve në ose autoritetet/shërbimet e jashtme. Stafi i shkollës duhet të ndjekë hapat/protokollet e referimit të përcaktuara në legjislacionin shqiptar.
- **Çështjet e shëndetit mendor** - Stafi i shkollës që ka shqetësime për sjelljen ose shëndetin mendor të një nxënësi mund të diskutojë me prindërit dhe t'i inkurajojë ata që të vlerësojnë fëmijën e tyre nga profesionistët ose të propozojnë mbështetje nga psikologu i shkollës.
- **Rrethanat ekstreme** - Stafi gjithashtu mund t'i referojë familjet në situata ekstreme të varfërisë ose rrethana shumë të vështira jetësore në shërbimet sociale. Kufijtë për ta bërë këtë mund të përshkruhen në legjislacion. Referimet nuk duhet të bëhen pa pëlqimin paraprak të familjeve.

Procedurat e referimit

Kur një anëtar i stafit të shkollës identifikon ose ka dyshime për abuzim, neglizhencë, dhunë ose probleme të shëndetit mendor, ai zakonisht duhet t'i raportojë drejtorisë së shkollës në mënyrë që rasti t'u referohet agjencive dhe shërbimeve të disponueshme në nivel lokal, me përjashtim të rasteve kur stafi drejtues i shkollës është i përfshirë në zbulim.

Është e rëndësishme që:

- Stafi i shkollës të jetë në dijeni të detyrimeve të raportimit
- Shkollat të kuptojnë procedurat ekzistuese të referimit për fusha të ndryshme dhe të informojnë dhe trajnojnë në mënyrë adekuate mësuesit për qëllimin dhe përdorimin e tyre

- Shkollat të caktojnë një pikë kontakti për mbrojtjen e fëmijëve, të cilit nxënësit dhe mësuesit mund të ngrenë çështje abuzimi ose dyshime për abuzim
- Shkollat të jenë të vetëdijshme për mbrojtjen e fëmijëve, shëndetin mendor dhe shërbimet e mbështetjes psikologjike të disponueshme në shkollë dhe në komunitet
- Shkollat të mbajnë një listë kontakti të përditësuar të shërbimeve të tilla
- Shkollat të mbajnë një listë të personave të kontaktit në institucionet kyçe për qëllime referimi
- Shkollat të komunikojnë informacion me pikën qendrore të shërbimit të mbrojtjes së fëmijëve dhe procedurat e referimit tek nxënësit, prindërit dhe stafi.

Mbrojtja e të dhënave:

SPH mbledh herë pas here **të dhëna sensitive**. Nxjerrja ose shpërndarja e të dhënave të tilla mund të dëmtojë potencialisht të rinjtë dhe familjet e tyre. Shkollat kanë nevojë për një politikë dhe protokolle për mbrojtjen e të dhënave për të siguruar që të dhënat e mbledhura përmes SPH të mbahen **konfidenciale**.

Kjo përfshin:

- Kufizoni nivelin e aksesit në dosjet e nxënësve vetëm për ata pak njerëz që punojnë drejtpërdrejt me nxënësin;
- Kufizoni aksesin në informacione konfidenciale vetëm për personelin e autorizuar në shkollë, siç është drejtori i shkollës ose psikologu i shkollës;
- Shmangni zbulimin e informacioneve sensitive kur rastet e nxënësve diskutohen në një takim grupi;
- Ndaloni që informacioni të shpërndahet me prindërit dhe/ose nxënësit e tjerë;
- Sigurohuni që informacioni i ruajtur ose i ndarë në mënyrë elektronike është i mbrojtur me fjalëkalim.

Hapi 4: Zbatimi i masave të ndërhyrjes dhe monitorimi

Qëllimi i përgjithshëm i një SPH është të jetë në gjendje të identifikojë ndërhyrjet e duhura të reagimit për të mbështetur mbajtjen në shkollë të nxënësve në rrezik të braktisjes, si dhe të nxisë mirëqenien e tyre. Në bazë të identifikimit të nevojave të nxënësve në rrezik braktisje, shkollat mund të zgjedhin dhe zbatojnë masa mbështetëse.

Në hapin 4, shkollat:

- planifikojnë ndërhyrjet dhe masat në përgjigje të nevojave të ndryshme të nxënësve në rrezik
- zbatojnë dhe koordinojnë këto ndërhyrje
- i referojnë rastet shërbimeve të jashtme aty ku është e nevojshme dhe punojnë së bashku me ekipe multidisiplinare dhe menaxherët e rasteve për të mbështetur fëmijët kur është e përshtatshme
- monitorojnë përparimin e nxënësve dhe rishikojnë masat në përputhje me rrethanat.

Përgjegjësitë:

Për çdo nxënësi në rrezik, Ekipi për Parandalimin e Braktisjes së Shkollës do të emërojë një '**menaxher rasti**', d.m.th. një pjesëtar të stafit të shkollës përgjegjës për kontaktin me nxënësin, familjen e tij dhe për monitorimin e zbatimit dhe rezultateve të masave mbështetëse.

Ky menaxher është shpesh psikolog shkolle ose mësues kujdestar. Në shkollat me përqindje të lartë të nxënësve në rrezik braktisjeje, është e rëndësishme që të mos mbingarkohen përgjegjësitë e mësuesve dhe të sigurohet që ngarkesa e punës të shpërndahet në të gjithë stafin.

Ndërkohë që menaxheri i rastit ka një përgjegjësi të përgjithshme për koordinimin dhe monitorimin, aktorë të ndryshëm do të jenë përgjegjës për zbatimin e një ose më shumë masave mbështetëse, duke përfshirë: vetë nxënësit në rrezik, familjet e tyre, bashkëmoshatarët, mësuesit, stafin tjetër të shkollës dhe ndoshta palët e jashtme të interesuara si p.sh. mentorë të rinjve, OJQ, staf/shërbime komunale dhe shërbime të tjera socio-ekonomike.

Rreth Menaxhimit të Rastit

Menaxhimi i rasteve përdoret zakonisht nga punonjësit socialë për të organizuar dhe koordinuar mbështetjen e shumë agjencive për fëmijët dhe familjet me nevoja të shumta. Qasja mund të përdoret gjithashtu nga shkollat kur koordinojnë ndërhyrjet parandaluese dhe reaguese për nxënësit në rrezik të braktisjes.

- *Rasti*: personi ose fëmija që ka nevojë për mbështetje
- *Menaxhimi*: procedura dhe mekanizma të organizuar

Në parandalimin e braktisjes së shkollës, **menaxhimi i rasteve synon**:

- Koordinimin, regjistrimin dhe monitorimin e aktiviteteve të ndërmarra nga shkolla për parandalimin dhe reagi
- min ndaj rrezikut të braktisjes së shkollës;
- Identifikimin dhe mobilizimin e burimeve të nevojshme brenda dhe jashtë shkollës për të mbështetur nxënësin;
- Mbledhjen së bashku të profesionistëve nga të gjithë sektorët dhe rrjetet informale për të mbështetur fëmijën në mënyrë holistike, kur është e nevojshme.

Procesi i menaxhimit të rastit përfshin:

- Një menaxher rasti
- Një rrjet mbështetës (p.sh. një ekip për parandalimin e braktisjes së shkollës, mësues, prindër/anëtarë të familjes, ndërmjetës, nxënës, anëtarë të tjerë të komunitetit sipas rastit)

Roli i menaxherëve të rastit zakonisht përfshin:

- Të jetë pika qendrore për familjen dhe të gjithë profesionistët që punojnë me nxënësin;
- Kontakti me nxënësin dhe familjen për të vlerësuar nevojat dhe për të gjetur zgjidhje;
- Organizimi i takimeve me të gjitha palët e interesuara për të identifikuar ndërhyrjet parandaluese;
- Zhvillimi, me ndihmën e Ekipit të Braktisjes së Shkollës, i një Planit Individual për Parandalimin e Braktisjes;
- Monitorimi i ecursë së aktiviteteve;
- Realizimi i takimeve me të gjitha palët e interesuara për të rishikuar treguesit kryesorë, për të rishikuar efektivitetin e masave për parandalimin e braktisjes së shkollës dhe për të planifikuar hapat e ardhshëm.

Ndërsa menaxheri i rastit koordinon aktivitetet për një rast, **ai nuk është personi i vetëm përgjegjës për vendimmarrjen**, monitorimin dhe rishikimin e progresit. Këto duhet të ndërmerren me anëtarë të tjerë të shkollës, të tilla si ekipi i parandalimit të braktisjes së shkollës ose mësues të tjerë, dhe/ose komuniteti kur është e nevojshme, së bashku me fëmijën dhe prindërit.

Procesi:

Nën procesin e përgjithshëm të 'menaxhimit të rasteve' dhe bazuar në vlerësimin e nevojave, një plan për parandalimin e braktisjes së shkollës hartohet nga ekipi i parandalimit të braktisjes së shkollës.

Një plan hartohet sapo të identifikohet një nxënës i ri në rrezik. Planet zgjasin për kohëzgjatjen e vitit shkollor dhe mund të përfshijnë aktivitete mbështetëse verore për të siguruar që nxënësi të rikthehet në shkollë në shtator.

Plani monitorohet nga Menaxheri i Rastit dhe rishikohet rregullisht nga Ekipi i Braktisjes së Shkollës (çdo 3-mujor apo më shumë). Rregullimet i bëhen planit bazuar në progresin dhe rezultatet, dhe në nevojat e reja të shfaqura për nxënësin.

Në disa raste, nxënësit do të kalojnë nga rreziku/rreziku i lartë i braktisjes në mosrrezikshmëri përgjatë disa muajve ose viteve. Në raste të tjera, nxënësit mund të mbeten në rrezik gjatë gjithë shkollimit të tyre.



Figura 4: Procesi i menaxhimit të rastit

Burimi: Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë e Kosovës dhe UNICEF (2014)

Shembull i strategjive mbështetëse për një adoleshent në rrezik të braktisjes:




Figura 5: Strategji mbështetëse për adoleshentët në rrezik braktisje

Mjetet:

Planet për Parandalimin e Braktisjes së Nxënësve janë mjete të dobishme për të regjistruar dhe koordinuar veprimet e ndërmarra nga shkolla për të kthyer një fëmijë në shkollë dhe për të parandaluar braktisjen. Një plan i thjeshtë do të përfshinte informacion mbi:

- **Faktorët e rrezikut të braktisjes** së nxënësit, bazuar në vlerësimin e nevojave, dhe informacion mbi parashikuesit/indiktorët kryesorë të braktisjes, si frekuentimi, sjellja, arritjet akademike, etj.;
- **Faktorët mbrojtës** dhe pikat e forta që mund ta ndihmojnë nxënësin të qëndrojë në shkollë, si interesat, talentet, rrjetet shoqërore, pjekuria emocionale, motivimi dhe pikat e tjera të forta;
- **Veprimet që duhen ndërmarrë, kur dhe nga kush:** ndërhyrjet që do të zbatohen nga shkolla, prindërit, nxënësi dhe aktorët e jashtëm të shkollës kurdoherë që është e rëndësishme, p.sh., përfaqësuesi i bashkisë, autoritetet arsimore...
- **Monitorimin e progresit.**

Planet Individuale të Parandalimit të Braktisjes së Shkollës funksionojnë më mirë kur prindërit dhe nxënësit janë të përfshirë në zhvillimin e tyre, kanë kontribuar në zgjidhjet e tyre dhe janë angazhuar në zbatimin e aktiviteteve specifike për të zvogëluar rrezikun e braktisjes. Përfshirja aktive e nxënësve në planifikimin për kthimin e tyre në shkollë/parandalimi i braktisjes së shkollës do të ndihmojë në krijimin e një ndjenje përkatësie dhe lidhjeje. Zakonisht një person qendror (Menaxheri i Rastit) është përgjegjës për hartimin e planit.

Plotësimi i formularëve mund të marrë kohë për mësuesit. Shkollat ftohen të gjejnë strategjitë që funksionojnë për to dhe ekipet e tyre, në mënyrë që të mbajnë në minimum barrën administrative.



Ndërsa menaxheri i rastit koordinon aktivitetet për një rast, **ai/ajo nuk është personi i vetëm përgjegjës për vendimmarrjen**, monitorimin dhe rishikimin e progresit. Këto duhet të ndërmerren me anëtarë të tjerë të shkollës, të tilla si ekipi i braktisjes së shkollës ose mësues të tjerë, dhe/ose komuniteti kur është e nevojshme, së bashku me fëmijën dhe prindërit.

Shembull i planit të parandalimit të braktisjes së nxënësve.

Plani i Parandalimit të Braktisjes së Nxënësve – Informacion i Përgjithshëm			
Emri i Nxënësit			Data e lindjes:
Menaxheri i Rastit			
Shenjat e braktisjes	Shenjat SPH	Të dhëna/Informacione	
	☐ Mungesa		
	☐ Sjellje e dobët...		
	☐ Arritje e dobët në mësim		
	☐ Drejtimi arsimor (adekuat)		
	☐ Faktorë rëndues (specifikoni)		
Sfidat dhe pengesat për mbajtjen, arritjen dhe përfundimin e arsimit me të cilat përballen nxënësi <i>(sipas prindërve, nxënësit dhe shkollës – perspektivat mund të ndryshojnë dhe duhet të pasqyrohen këtu)</i>			
Pikat e forta të nxënësit (faktorët mbrojtës, interesat, talentet, aftësitë...) <i>(perspektivat mund të ndryshojnë dhe duhet të pasqyrohen këtu)</i>			

Masat					
Çfarë? Përshkrimi i masave të ndërhyrjes	Për çfarë? Rezultatet e pritura	Deri kur? Afati i zbatimit	Kush? Personi përgjegjës për zbatimin	Komentet (mbi zbatimin, burimet e nevojshme, etj.)	Data e rishikimit

Referimi	
A është referuar nxënësi në shërbime/profesionistë të jashtëm?	Po/Jo..... Data: Detaje:

Mbyllja e çështjes	
Data	
Koment	

Qasja me tre nivele për parandalimin e braktisjes

Ndërkohë që çdo nxënës kërkon një nivel mbështetjeje gjatë gjithë shkollimit të tyre, disa hasin pengesa më të mëdha dhe kanë nevojë për më shumë mbështetje se të tjerët. Prandaj, sfida për shkollat është të adresojnë nevojat themelore të të gjithë nxënësve, duke iu përgjigjur nevojave specifike ose barrierave të atyre që janë më të rrezikuar nga mosangazhimi dhe braktisja e shkollës.

Për këtë qëllim, një model i thjeshtë për konceptimin e mbështetjes së nxënësve në shkollë dhe ndërhyrjeve të braktisjes është një **qasje me tre nivele**³ që kategorizon ndërhyrjet sipas **nivelit të intensitetit** për grupe specifike:

- Ndërhyrje **universale**, për të gjithë nxënësit dhe në dobi të gjithë komunitetit të shkollës,
- Ndërhyrje **të targetuara**, për nxënësit në rrezik që kërkojnë mbështetje shtesë, dhe
- Ndërhyrje **të përshtatura**, për nxënësit me rrezik shumë të lartë të braktisjes që kërkojnë mbështetje shumë intensive dhe të individualizuar.




Figura 6: Qasja me tre nivele për parandalimin e braktisjes së shkollës

Burimi: Përshtatur nga UNICEF (2017) dhe Departamenti i Arsimit Eire (2021)

Qasja me tre nivele mishëron parimet e një qasjeje me dy drejtime të të gjithë shkollës për parandalimin e braktisjes së shkollës, pasi shkollat adresojnë nevojat e të gjithë nxënësve (ndërhyrjet universale), ndërkohë që ofrojnë mbështetje shtesë për nxënësit në rrezik ose më të cënueshëm (e targetuar/ndërhyrjet e përshtatura).

Nëse është e mundur, shkollat duhet të përfshijnë parandalimin e braktisjes së shkollës në praktikat e rregullta që u drejtohen të gjithë nxënësve (**universale**). Këto janë më pak të kushtueshme sesa ndërhyrjet e targetuara ose të përshtatura dhe përfshijnë njoftimin e prindërve dhe fëmijëve për mungesat në ditën që ata mungojnë, politikat e frekuentimit të shkollës, mbështetjen e të mësuarit në klasë për ata me arritje të ulëta, politikat kundër ngacmimit, pjesëmarrjen e nxënësve në

³ Kjo bazohet në Reagimin ndaj Ndërhyrjes, një qasje me shumë nivele e zhvilluar në SHBA për identifikimin dhe mbështetjen e hershme të nxënësve me nevoja të të mësuarit dhe sjellje (shih <http://www.rtinetwork.org/learn/what/whatisrti> për më shumë informacion). Variacionet e këtij modeli që atëherë janë zhvilluar dhe përdorur në të gjithë botën në të gjithë sektorët, veçanërisht në ndihmën sociale dhe arsim.

vendimmarrjet e shkollës dhe aktivitetet jashtëshkollore. Për disa grupe nxënësish kërkohen masa **të targetuara**, si p.sh. klasa shtesë për nxënësit me arritje të ulëta, mentorimi, ose lidhja e ngushtë prind-nxënës-shkollë. Për nxënësit që përballen me situata më komplekse, është e nevojshme një mbështetje individuale dhe intensive **e përshtatur**, si mësimdhënie shtesë individuale, një plan individual i mbështetur nga ekipe shumëdisiplinore, takime për rastin ose akses në shërbime të shumta mbështetëse, brenda dhe jashtë shkollës.

Një qasje e gjithë shkollës për mbështetjen gjithëpërfshirëse të parandalimit të braktisjes së shkollës përfshin disa fusha të ndërlidhura. Parandalimi i braktisjes së shkollës është më efektiv kur përfshihet në të gjitha fushat, d.m.th., në shkollë, në klasë dhe në ndërveprimet dhe rolin e nxënësve, prindërve dhe familjeve, agjencive të jashtme dhe grupeve më të gjera të komunitetit.

Më poshtë është një kornizë që përmbledh rolin që çdo fushë dhe/ose palë e interesuar mund të luajë në parandalimin e braktisjes së shkollës.



Grafiku 3: Palët e interesuara për parandalimin e braktisjes së shkollës

Burimi: Përshtatur nga Lavrentsova dhe Valkov (2017)

Më konkretisht, çdo fushë lidhet me braktisjen dhe parandalimin e saj, si më poshtë:

Fusha	Përshkrimi
Shkolla	Lidhur me punën e menaxhimit të shkollës dhe organizimin, strukturën, burimet dhe praktikën e shkollës: (i) morali dhe politikat e shkollës, (ii) lidhësit, (iii) qeverisja, (iv) menaxhimi, (v) burimet dhe kapacitetet njerëzore, (vi) mjedisi dhe klima e shkollës, (vii) praktikën shkollë në lidhje me të nxënësit, mirëqenien, mungesat, frekuentimin, etj.
Klasa	Lidhur me punën e mësuesve, organizimin e klasës dhe praktikën e mësimdhënies dhe të nxënësit: (i) kurrikula, (ii) praktikën e mësimdhënies dhe të

Fusha	Përshkrimi
	nxënit, (iii) mbështetjen e të mësuarit, (iv) zhvillimin e aftësive, (v) orientimin në karrierë.
Nxënësit	Lidhur me (i) ndjenjën e përkatësisë në shkollë, (ii) mirëqenien, (iii) zhvillimin e aftësive socio-emocionale, (iv) mbështetjen individuale dhe në grup, dhe (v) përfshirjen e nxënësve në parandalimin e braktisjes së shkollës.
Prindërit	Lidhur me (i) strategjitë e shkollës për të angazhuar prindërit në shkollë, (ii) strategjitë e komunikimit shkollë-shtëpi, (iii) strategjitë për të mbështetur prindërit që të angazhohen në mbështetjen e fëmijëve të tyre, (iv) strategjitë për të angazhuar prindërit në parandalimin e braktisjes së shkollës.
Agjencitë dhe shërbimet e jashtme	Lidhur me koordinimin e shumë agjencive, duke përfshirë (i) procedurat e referimit në mbështetje të jashtme, (ii) ndërhyrjet e përbashkëta për parandalimin e braktisjes së shkollës.
Komuniteti më i gjerë	Lidhur me: (i) zhvillimin e partneritetit, (ii) strategjitë e pjesëmarrjes së komunitetit për parandalimin e braktisjes së shkollës.

Tabela 6: Palët e interesuara për parandalimin e braktisjes së shkollës

!	Kriteret e efektivitetit për ndërhyrjet, parandalimin dhe reagimin ndaj braktisjes
	Në përgjithësi, përvoja tregon se ndërhyrjet e braktisjes janë më efektive kur ato janë: • Holistike, duke mbuluar aspekte të ndryshme të jetës së nxënësit, edhe familjare; • Në kohën e duhur, zbatuar sa më herët; • Individuale, bazuar në nevojat e veçanta të një djali apo vajze ose të familjes së tyre; • Të zbatuara në mënyrë konsistente nga të gjitha palët e interesuara; • Të ofruara për një periudhë të gjatë kohore; • Ndërhyrjet pjesëmarrëse dhe fuqizuese, d.m.th., vendosen bashkërisht me nxënësin/familjen dhe që bazohen në pikat e forta të familjes, talentet dhe potencialin e nxënësit; • Të koordinuara, ndërmjet stafit të shkollës dhe agjencive; • Të monitoruara dhe vlerësuar, të rishikohet se çfarë funksionon më mirë, çfarë nuk funksionon dhe të ndahet informacioni mbi praktikatat e ndërhyrjes së braktisjes së shkollës.

Shembuj të masave për parandalimin dhe reagimin ndaj braktisjes së shkollës për nxënësit në rrezik jepen në seksionet vijuese të manualit.

Hapi 5: Vlerësimi dhe të mësuarit

Vlerësimi i SPH, mësimi rreth asaj që funksionon dhe çfarë mund të përmirësohet janë çelësi për përmirësimin e efektivitetit dhe ndikimit të tij tek nxënësit në rrezik të braktisjes dhe në praktikatat e shkollës më gjerësisht.

Në hapin 5, shkollat:

- vlerësojnë rëndësinë e treguesve, efikasitetin e proceseve dhe mjeteve të SPH, efektivitetin e ndërhyrjeve dhe ndikimin tek nxënësit, prindërit, mësuesit, praktikantët e moralin e shkollës
- angazhojnë të gjithë aktorët e shkollës në aktivitetet e rishikimit dhe vlerësimit, duke përfshirë mësuesit, nxënësit, prindërit, menaxherët dhe palët e jashtme të interesuara
- rishikojnë dhe përmirësojnë treguesit, proceset dhe ndërhyrjet e reagimit të SPH bazuar në evidenca
- ndajnë eksperiencën me shkollat e tjera, autoritetet lokale dhe agjenci të tjera.

Shkollat mund të mbledhin dhe analizojnë të dhëna sasiore me kalimin e kohës, të tilla si të dhëna për braktisjen e shkollës, mungesat dhe rezultatet e të nxënësve për nxënësit në rrezik të braktisjes dhe nxënësit e tjerë. Ato gjithashtu mund të mbledhin të dhëna sasiore përmes pyetësorëve të anketimit dhe të dhëna cilësore përmes diskutimeve në fokus grupe me nxënës, mësues, prindër dhe aktorë të jashtëm.

Shkollat gjithashtu duhet të maksimizojnë mundësitë për të pasur diskutime me nxënësit që kanë braktisur shkollën dhe familjet e tyre për të dëgjuar pikëpamjet mbi arsyet e braktisjes. Ndërkohë që një ekip i vogël shkolle mund të punojë në mbledhjen e të dhënave, gjetjet mund të diskutohen dhe rekomandimet të formulohen në një grup më të madh. Dëshmitë nga rishikimi i SPH mund të ndahen gjatë vlerësimeve dhe inspektimeve të jashtme të shkollës.

Shembull i pyetjeve të rishikimit dhe praktikës reflektuese

- A ishin nxënësit në rrezik të braktisjes së shkollës të identifikuar herët nga SPH?
- Cili ishte profili i braktisësve të hershëm të shkollës të cilët nuk ishin identifikuar nga SPH?
- Si mund të na ndihmojë ky informacion të rregullojmë saktë treguesit e përdorur në SPH dhe të përmirësojmë aftësinë e stafit për të njohur shenjat e braktisjes së mundshme?
- A ka karakteristika të përbashkëta mes nxënësve që braktisin shkollën apo mes arsyeve të braktisjes së tyre?
- Cilat ndërhyrje kanë qenë më të suksesshme për të parandaluar braktisjen dhe për të rritur shkallën e frekuentimit dhe për kë?
- Çfarë ndikimi kanë pasur ndërhyrjet e ndryshme tek nxënësit në rrezik braktisje përsa i përket frekuentimit, të mësuarit dhe mirëqenies socio-emocionale?
- Cilat janë pikëpamjet e prindërve dhe nxënësve, niveli i tyre i kënaqësisë dhe rekomandimet për përmirësimin e strategjive për parandalimin e braktisjes së shkollës?
- Cilat janë pikëpamjet e mësuesve, personelit mbështetës dhe drejtuesve mbi nivelin e tyre të kënaqësisë dhe rekomandimet për të përmirësuar procesin e SPH dhe strategjitë për parandalimin e braktisjes së shkollës?
- Cilat janë pikëpamjet dhe rekomandimet e shërbimeve të jashtme dhe autoriteteve arsimore për përmirësimin e SPH?
- Çfarë duhet të ndryshojmë në çdo hap të SPH për ta bërë atë më efektiv?

Reflektim

1. Cilat mjete për vlerësimin e nevojave janë në dispozicion në shkollën tuaj, nëse ka? Cilat janë pikat e forta dhe të dobëta të tyre?
2. Rishikoni se si shkolla juaj organizon mbështetjen për nxënësit në rrezik të braktisjes. Identifikoni pikat e forta dhe të dobëta.
3. Deri në çfarë mase do t'ju ndihmonte zhvillimi i një sistemi të menaxhimit të rasteve t'i mbështesni në mënyrë më efektive nxënësit në rrezik të braktisjes?

BURIME SHITESË

- Attendance Works (2020) - <https://www.attendanceworks.org/chronic-absence/addressing-chronic-absence/monitoring-attendance-in-distance-learning/>
- UNICEF (2018) *Early Warning Systems for Students at Risk of Dropping Out*. Gjenevë: Zyra Rajonale e UNICEF-it për Evropën dhe Azinë Qendrore.
- UNICEF (2017) *Improving Education Participation: Tregues politikash dhe praktikë për regjistrimin e të gjithë fëmijëve dhe adoleshentëve në shkollë dhe parandalimin e braktisjes*. Seria e UNICEF-it për Pjesëmarrjen në Arsim dhe Parandalimin e Braktisjes, Vëllimi 2. Gjenevë: UNICEF ECARO.

DETYRË

Zbatoni konceptet dhe informacionin nga ky seksion në kontekstin e shkollës suaj me Detyrën 2 nga Kapitulli 6.

4. PLANIFIKIMI I SHKOLLËS PËR PARANDALIMIN E BRAKTISJES

Kërkohet një qasje e tërë e shkollës për të trajtuar në mënyrë efektive braktisjen. Kjo kërkon që shkollat të identifikojnë dhe adresojnë nevojat e nxënësve dhe komuniteteve të tyre dhe të angazhohen në procese të vazhdueshme përmirësimi.

Kjo bëhet nëpërmjet një vlerësimi dhe planifikimi transparent dhe pjesëmarrës, si dhe hartimit të planeve të zhvillimit të shkollës që trajtojnë çështjen e braktisjes së shkollës dhe faktorët themelorë që po shtyjnë disa nxënës të largohen nga shkolla përpara se të përfundojnë AFP.

PROCESI I PLANIFIKIMIT

Etosi, vizioni dhe vlerat

Një qasje e tërë e shkollës për parandalimin e braktisjes së shkollës promovon një kulturë dhe moral pozitiv dhe bashkëpunues, i cili përfshin të gjithë aktorët e shkollës dhe krijon lidhje të forta me komunitetin përreth shkollës. Ai përfshin:

- **Një moral dhe kulturë shkollore** që përpiqet të zhvillojë një mjedis:
 - të favorshëm për përfundimin e shkollës dhe tranzicionin arsimor,
 - bazuar në vlerat dhe besimet themelore që të gjithë fëmijët dhe të rinjtë mund të kenë sukses dhe se asnjë nxënës nuk duhet të lihet pas,
 - të angazhuar me aktivitete dhe praktika që nxisin arritjet në arsim, rrisin aspiratat arsimore dhe reduktojnë braktisjen,
 - mbështetës të stafit të shkollës, dhe
 - fuqizues të nxënësve dhe familjeve të tyre.
- **Një vizion shkollor** për parandalimin e braktisjes së shkollës
- Një **grup vlerash** të përbashkëta ndërmjet të gjithë aktorëve të shkollës. Vlerat janë baza mbi të cilën të gjithë aktorët e shkollës marrin vendime dhe veprojnë (në praktikë).
- **Planifikimin dhe monitorimin** për të përmirësuar praktikën dhe për të mësuar nga përvoja.

Planifikimi për braktisjen e shkollës

Një cikël i thjeshtë i planifikimit të shkollës është qasja Vlerëso, Planifiko, Bëj, Rishiko:




Figura 7: Vështrim i përgjithshëm i ciklit të planifikimit të shkollës

Ashtu si çdo aktivitet tjetër i planifikimit të shkollës, planifikimi për parandalimin e braktisjes së shkollës bëhet më së miri me pjesëmarrje, **duke përfshirë të gjitha palët e interesuara në të gjitha fazat e ciklit të planifikimit**. Për parandalimin e braktisjes së shkollës është veçanërisht e rëndësishme të përfshihen:

- Menaxhimi i shkollës
- Mësuesit
- Personel tjetër i shkollës: psikologë shkollorë, infermierë të shkollës, bibliotekarë, ndihmës mësues, ndërmjetës shkollorë, vullnetarë, etj.
- Nxënësit
- Prindërit dhe familjet
- Shërbimet e jashtme (shërbimet sociale dhe shëndetësore, komunat, OJQ-të) dhe komuniteti më i gjerë (bizneset, shoqatat, etj.)

Fillimi i procesit të planifikimit dhe bashkimi i njerëzve zakonisht bëhet nga drejtuesit e shkollës, ndonjëherë nga një ekip i shkollës (p.sh. ekipi për parandalimin e braktisjes së shkollës). Pavarësisht se kush e nis procesin e planifikimit, është e rëndësishme të sigurohet që të përvijohen **përgjegjësi të qarta** për analizën e situatës (Vlerëso), planifikimin (Planifiko), zbatimin (Bëj) dhe monitorimin dhe vlerësimin e planit (Rishiko).

Diagrami i mëposhtëm përmbledh pyetjet kryesore që shkollat duhet t'i bëjnë vetes kur planifikojnë parandalimin dhe reagimin e braktisjes së shkollës.




Figura 8: Pyetje udhëzuese për planifikimin e shkollës

Burimi: Përshtatur nga UNICEF Kosovë dhe MASH (2014).

Shkollat inkurajohen të ndërtojnë një sërë aktivitete parandaluese të braktisjes në planin e tyre kryesor të shkollës.

Reflektim

Reflektoni mbi frymën e shkollës dhe masën në të cilën ajo është mbështetëse për parandalimin e braktisjes. Përmbliidni pikat kryesore të diskutimit tuaj sipas (i) atmosferës/mjedisit të shkollës, (ii) vlerave të shkollës, (iii) praktikave dhe aktiviteteve të shkollës.

VETË-VLERËSIMI I SHKOLLËS

Vetë-vlerësimi i shkollës mund të bëhet në mënyra të ndryshme. Më poshtë janë disa shabllone që do ta mbështesin shkollën tuaj në vlerësimin se ku është tani për sa i përket parandalimit të braktisjes dhe komponentëve të ndryshëm të parandalimit të braktisjes për të mbështetur përmirësimin në zonat më të dobëta.

Vetë-vlerësimi i shkollës për parandalimin e braktisjes së shkollës (gjenerike)

Funksionet e kapacitetit	Fort në rregull	Pranueshëm	Kërkon përmirësim	Boshllëqe të mëdha	Komente
Shkolla e bën parandalimin e braktisjes së shkollës një prioritet kryesor					
Shkolla ka një ekip/individë të përkushtuar për parandalimin e braktisjes					

Funksionet e kapacitetit	Fort në rregull	Pranueshëm	Kërkon përmirësim	Boshllëqe të mëdha	Komente
së shkollës					
Etika e shkollës mbështet parandalimin e braktisjes së shkollës					
Shkolla identifikon nxënësit në rrezik të braktisjes rregullisht (është vendosur një sistem)					
Shkolla analizon të dhënat për mungesat dhe braktisjen e shkollës për të informuar ndërhyrjet e saj për parandalimin e braktisjes					
Shkolla ka një qasje të gjithë shkollës për parandalimin e braktisjes, duke përfshirë ndërhyrjet e synuara për grupet e fëmijëve më të rrezikuar					
Shkolla ka një sistem për të planifikuar dhe monitoruar ndërhyrjet individuale për parandalimin e braktisjes					
Shkolla përdor strategji të mirëseardhjes kur nxënësit që mungojnë në mënyrë kronike kthehen në shkollë					
Shkolla mbështet nxënësit në rrezik të kalueshmërisë					
Shkolla miraton një qasje me tre nivele për mbështetjen e mirëqenies					
Shkolla promovon aktivitete të synuara mbështetëse të mirëqenies për nxënësit në rrezik					
Shkolla promovon marrëdhënie pozitive midis mësuesve, të rriturve të tjerë dhe nxënësve					
Shkolla trajton në mënyrë aktive paragjykimet dhe diskriminimin, veçanërisht drejt gjinisë, përkatësisë etnike dhe aftësisë së kufizuar					
Shkolla miraton një qasje me tre nivele për mbështetjen e të mësuarit					
Shkolla zbaton aktivitete mbështetëse mësimore për nxënësit në rrezik					

Funksionet e kapacitetit	Fort në rregull	Pranueshëm	Kërkon përmirësim	Boshllëqe të mëdha	Komente
Shkolla i kupton barrierat për pjesëmarrjen e prindërve					
Shkolla zbaton praktika efektive komunikimi me prindërit					
Shkolla zbaton strategji për prindërit e përfshirë me vështirësi					
Shkolla zbaton strategji për të përfshirë prindërit më të marginalizuar dhe më të paarrtshëm në mësimin e fëmijëve të tyre					
Shkolla angazhohet dhe punon në mënyrë efektive me agjencitë/shërbimet e jashtme					
Shkolla është në dijeni të procedurave të referimit në rast të dhunës, abuzimit dhe neglizhencës ndaj fëmijëve					
Shkolla angazhohet dhe punon në mënyrë efektive me komunitetet					
Shkolla mbledh dhe analizon të dhëna për të mbështetur planifikimin dhe vlerësimin e parandalimit të braktisjes					
Shkolla përfshin parandalimin e braktisjes së shkollës në procesin e vetë-vlerësimit dhe planifikimit të zhvillimit të shkollës					
Shkolla monitoron, vlerëson dhe mëson nga aktivitetet për parandalimin e braktisjes					
Shkolla vlerëson se si punon së bashku si një ekip për parandalimin e braktisjes					
Shkolla ndan përvojën dhe praktikën më të mira për parandalimin e braktisjes së shkollës me shkollat e tjera dhe me autoritetet arsimore					

Vetë-vlerësimi: praktikat shkollore në angazhimin e prindërve

Më poshtë është një mjet për të vlerësuar se sa mirë po ecën shkolla juaj në komunikimin dhe angazhimin me prindërit.

Domenet	E papërshtatshme	Kërkon përmirësim	Mirë	E shquar	Komente
Mirëseardhja e prindërve					
Sa mikpritëse është shkolla juaj për prindërit?					
Sa mirë mund të akomodojnë ambientet e shkollës suaj mbledhjet e prindërve dhe aktivitetet e prindërve në shkollë?					
Sa mirë ofron shkolla juaj përkthimin e dokumenteve/interpretimin e takimeve të prindërve?					
Pjesëmarrja e prindërve					
Sa mirë konsultohet shkolla juaj me të gjithë prindërit dhe i konsideron pikëpamjet dhe zgjidhjet e tyre?					
Sa mirë angazhohet shkolla juaj me prindërit e marginalizuar dhe me ata që janë 'të vështirë për t'u arritur'?					
Sa mirë konsulton shkolla juaj me prindërit më pak të përfshirë se çfarë do të gjenin të dobishme për të mbështetur angazhimin e tyre?					
Sa mirë i përfshin shkolla juaj të gjithë prindërit në aktivitetet dhe ngjarjet shkollore, duke përfshirë edhe më të marginalizuarit?					
Sa mirë i përfshin shkolla juaj të gjithë prindërit në strukturat vendimmarrëse dhe qeverisëse (bordi i shkollës, etj), përfshirë më të marginalizuarit?					
Komunikimi me prindërit					
Sa mirë i njeh shkolla juaj personalisht prindërit e nxënësve të tyre?					

Domenet	E papërshtatshme	Kërkon përmirësim	Mirë	E shquar	Komente
Sa efektive janë strategjitë e shkollës suaj për të komunikuar me prindërit më të marginalizuar ose 'të vështirë për t'u arritur'?					
Sa mirë i komunikon shkolla juaj pritshmëritë e shkollave për rolin e prindërve?					
Sa mirë komunikon shkolla juaj me prindërit për mësimin e fëmijëve (problemet, përparimin dhe arritjet)?					
Sa mirë komunikon shkolla juaj me prindërit për mirëqenien socio-emocionale të fëmijëve?					
Sa mirë komunikon shkolla juaj me prindërit për shërbimet mbështetëse të disponueshme në komunitet?					
Angazhimi i prindërve në mësim					
Sa mirë u ofron shkolla juaj informacion të gjithë prindërve mbi sistemin arsimor, duke përfshirë prindërit në disavantazh/'të vështirë për t'u arritur'?					
Sa mirë i përdor shkolla juaj të gjitha njohuritë dhe ekspertizën e prindërve për të mbështetur kurrikulën dhe aktivitetet shkollore?					
Sa mirë i mbështet shkolla juaj prindërit me këshilla dhe burime për të mbështetur mësimin në shtëpi?					
Sa mirë i mbështet shkolla juaj prindërit më të marginalizuar që të angazhohen në mësimin e fëmijëve të tyre gjatë gjithë pandemisë, duke përfshirë mësimin në distancë dhe në internet?					
Kapaciteti për angazhimin e prindërve					
Sa mirë i trajton stafi i shkollës konfliktet me prindërit?					
Sa mirë është i trajnuar stafi juaj për praktikatat e angazhimit prindëror?					
Sa efektivisht planifikon shkolla juaj për komunikimin dhe angazhimin e prindërve					

Domenet	E papërshtatshme	Kërkon përmirësim	Mirë	E shquar	Komente
për nxënësit më vulnerabël dhe ata që rrezikojnë ta braktisin shkollën?					

Burimi: Frymëzuar dhe përshtatur nga Her Majesty Inspectorate of Education (2006) dhe nga http://www.involve-migrants-improve-school.eu/fileadmin/user_upload/Toolbox_3_Collaborating/3.1.pdf

Mjet i vetë-vlerësimit për punën efektive të shumë agjencive

Më poshtë është një mjet i thjeshtë vetë-vlerësimi që shkollat mund të përdorin për të vlerësuar se sa efektive është puna e tyre në shumë agjenci në kontekstin e parandalimit të braktisjes.

Si mund të duket puna efektive me shumë agjenci në kontekstin e parandalimit të braktisjes	Norma 0-4	Ndikimi aktual në parandalimin e braktisjes së shkollës (i ulët, i mesëm, i lartë)
Shkolla juaj		
Stafi i shkollës është i vetëdijshëm për rolin dhe mandatin e autoriteteve vendore, agjencive dhe shërbimeve të sektorëve të tjerë në lidhje me parandalimin e braktisjes së shkollës (policia, shërbimet sociale, shëndetësia, autoriteti vendor/zyrtarët e bashkisë, autoritetet lokale të arsimit, etj.)		
Stafi i shkollës është trajnuar për çështjet e mbrojtjes së fëmijëve		
Shkolla ka një drejtor dhe detaje kontakti për të gjitha autoritetet lokale, agjencitë dhe shërbimet përkatëse (policia, shërbimet sociale, shëndetësia, zyrtarët lokalë, etj.)		
Shkolla përdor proceset/protokollet ekzistuese të referimit në mënyrë efektive për të sinjalizuar familjet në nevojë tek agjencitë e tjera		
Shkolla përdor proceset/protokollet ekzistuese të referimit në mënyrë efektive për të sinjalizuar fëmijët në nevojë tek agjencitë e tjera		
Shkolla i referon nxënësit me rrezik të lartë për t'u braktisur në agjenci/shërbime të tjera për mbështetje shtesë		

Si mund të duket puna efektive me shumë agjenci në kontekstin e parandalimit të braktisjes	Norma 0-4	Ndikimi aktual në parandalimin e braktisjes së shkollës (i ulët, i mesëm, i lartë)
Shkolla kërkon mbështetje nga agjenci/shërbime të tjera në aktivitetet e parandalimit të braktisjes së shkollës		
Shkolla u jep agjencive të tjera informacion në kohë për fëmijët sipas/kur kërkohet (format letre ose elektronik)		
Shkolla kontribuon në Menaxhimin e Rasteve ndërinstitucionale për familjet/fëmijët në nevojë		
Shkolla u ofron prindërve, familjeve dhe nxënësve një sërë informacionesh rreth shërbimeve të disponueshme (shërbimet sociale, përfitimet, certifikatat e lindjes, shëndeti, etj.)		
Shkolla kontribuon në planifikimin e shumë agjencive, në nivel vendor, për çështjet që kanë të bëjnë me braktisjen e shkollës (p.sh. planet e parandalimit të braktisjes së shkollës komunale/rajonale; planet e mirëqenies së fëmijëve të bashkisë/rajonale; planet rinore komunale/rajonale...)		
Të tjera		
Agjencitë dhe shërbimet e jashtme		
Shkollës i sigurohet në mënyrë rutinore informacione për familjet/fëmijët që përballen me probleme të shumta nga agjenci të tjera		
Shkolla pajiset me informacion kur kërkohet për nxënësit në rrezik të braktisjes nga agjencitë e tjera (sipas protokolleve të mbrojtjes së të dhënave)		
Shkolla është e ftuar të marrë pjesë në Menaxhimin e Rasteve ndërinstitucionale për familjet/fëmijët në nevojë		
Shkollës i sigurohet informacioni përkatës nga autoritetet lokale, agjencitë dhe shërbimet (p.sh. protokollet, formularët e referimit, programet e disponueshme, udhëzimet, politikat, planet strategjike etj.)		
Shkolla konsultohet me planifikimin e shumë agjencive në nivel lokal, për çështje që kanë të bëjnë me braktisjen e shkollës (p.sh. planet e parandalimit të braktisjes së shkollës së bashkisë/rajonale; planet e mirëqenies së fëmijëve të bashkisë/rajonale; planet rinore të bashkisë/rajonale...)		

Si mund të duket puna efektive me shumë agjenci në kontekstin e parandalimit të braktisjes	Norma 0-4	Ndikimi aktual në parandalimin e braktisjes së shkollës (i ulët, i mesëm, i lartë)
Të tjera		

Mjet i vetë-vlerësimit për partneritetet shkollë-komunitet

Më poshtë është një formular i thjeshtë vetë-vlerësimi për shkollën për të vlerësuar partneritetin në punën me organizatat e komunitetit në kontekstin e parandalimit të braktisjes së shkollës.

Si mund të duket në praktikë partneriteti në komunitet për parandalimin e braktisjes së shkollës	Norma 0-4	Ndikimi aktual në parandalimin e braktisjes së shkollës (i ulët, i mesëm, i lartë)
Shkolla punon në partneritet me disa organizata komunitare, OJQ ose organizata të shoqërisë civile për parandalimin e braktisjes së shkollës		
Shkolla ka hartuar dhe ka detaje kontakti të të gjitha organizatave të mundshme të komunitetit, OJQ-ve ose organizatave të shoqërisë civile të cilat mund të kontribuojnë në parandalimin e braktisjes		
Shkolla punon me organizatat e komunitetit lokal për të angazhuar familje, veçanërisht familje nga pakicat etnike ose grupe tradicionalisht të përjashtuara, familje nga fëmijë me aftësi të kufizuara dhe familje të vështira për t'u arritur.		
Shkolla u ofron familjeve një sërë informacionesh rreth aktiviteteve dhe shërbimeve të disponueshme në komunitet, duke përfshirë mundësitë e mësimi të të rriturve, klasat e prindërve, mbështetjen psikologjike, aktivitetet edukative dhe rekreative, mbështetjen administrative, etj.		
Organizatat e komunitetit lokal ofrojnë aktivitete për nxënësit në shkollë, duke përfshirë ata në rrezik të braktisjes (orientim karriere, klube, aktivitete		

Si mund të duket në praktikë partneriteti në komunitet për parandalimin e braktisjes së shkollës	Norma 0-4	Ndikimi aktual në parandalimin e braktisjes së shkollës (i ulët, i mesëm, i lartë)
jashtëshkollore, kurse sipërmarrjeje, simulime biznesi, zhvillim të aftësive socio-emocionale, etj.)		
Shkolla kontribuon në programet e parandalimit të braktisjes së shkollës nga organizatat komunitare, ose programet e kthimit në shkollë		
Shkolla hap mjediset e saj për organizatat lokale dhe komunitare për të zhvilluar aktivitetet e tyre pas orarit të mësimt		
Përfaqësuesit e komunitetit janë pjesë e bordit të shkollës dhe kontribuojnë në planin zhvillimor të shkollës		
Përfaqësuesit e komunitetit kontribuojnë në zhvillimin e planit të parandalimit të braktisjes së shkollës (ose komponentit të parandalimit të braktisjes së planit të zhvillimit të shkollës)		
Dyqanet ose bizneset lokale mbështesin ose sponsorizojnë ngjarje sociale dhe iniciativa për mbledhjen e fondeve, ose japin kohën e tyre vullnetare për të ndihmuar shkollën dhe nxënësit në rrezik të braktisjes (p.sh. mentorimi)		
Bizneset lokale kontribuojnë në parandalimin e braktisjes së shkollës duke ofruar vende për përvojë pune ose duke ardhur në shkollë për të folur për punën e tyre		

Burimi: Përshtatur nga Qeveria e Uellsit (2015) Paketa e mjeteve për angazhimin e familjes dhe komunitetit.

DETYRA TË PUNËS NË GRUP

Përdorni detyrat e mëposhtme për të zbatuar konceptet dhe informacionin nga ky manual në kontekstin tuaj të shkollës profesionale.

Kur është e mundur, kryeni këtë detyrë në grup, me disa anëtarë të shkollës suaj, duke përfshirë: drejtorin dhe nëndrejtorët e shkollës, mësuesit, stafin tjetër si pedagogë, psikologë, mësues specialë dhe mësues ndihmës. Për rezultate më të mira, mund të konsideroni gjithashtu përfshirjen e nxënësve, prindërve, shërbimeve të jashtme dhe palëve të interesit të komunitetit në këtë ushtrim. Kjo analizë e situatës do të ndërtohet duke shtuar informacion nga detyrat e moduleve të tjera.

DETYRA 1: ANALIZA E SITUATËS

Kryeni një analizë të situatës për të kuptuar më mirë fenomenin e braktisjes në shkollën tuaj.

Hapi 1: Cilët janë nxënësit (profili) që braktisin shkollën tuaj? Kur e braktisin? (gjatë kalimit nga shkolla e mesme e ulët? Në javët e para? Në vitin e parë/vitin e fundit? Kur janë në punë?) Nga cili kurs/vit/drejtimit e braktisin atë (Ku)? Pse po braktisin? Përdorni të gjitha të dhënat e disponueshme nga vitet e mëparshme për: (i) profilizimin e nxënësve që braktisin shkollën (mosha, gjinia, përkatësia etnike, etj.), (ii) identifikimi i tendencave të braktisjes për grupe specifike.

Hapi 2: Kryeni një analizë SWOT për të identifikuar mjedisin e shkollës dhe praktikën e shkollës dhe stafit që mund të kontribuojnë në braktisje dhe që mund të zbusin atë.

	E dobishme për parandalimin/reduktimin e braktisjes	E dëmshme për parandalimin/reduktimin e braktisjes
E brendshme (nivel shkollë)	Pikat e forta (Faktorët e shkollës që ka të ngjarë të kenë një efekt pozitiv ose të jenë një nxitës për të reduktuar braktisjen e shkollës.)	Dobësitë (Faktorët e shkollës që ka të ngjarë të kenë një efekt negativ në - ose të jenë pengesë për reduktimin e braktisjes.)
E jashtme (mjedisi)	Mundësitë (Faktorët e jashtëm që ka të ngjarë të kenë një efekt pozitiv në reduktimin e braktisjes në shkollën tuaj.)	Kërcënimet (Faktorët dhe kushtet e jashtme që ka të ngjarë të kenë një efekt negativ në reduktimin e braktisjes në shkollën tuaj.)

Hapi 3: Hartoni legjislacionin dhe rregulloret kryesore në lidhje me parandalimin e braktisjes së shkollës në Shqipëri dhe identifikoni përgjegjësitë specifike të shkollave të mesme të ulëta, të mesme të larta, AFP dhe aktorëve të tjerë në parandalimin dhe reagimin ndaj braktisjes.

Hapi 4: Mendoni se çfarë ka funksionuar/nuk ka funksionuar në parandalimin e braktisjes së shkollës në shkollën tuaj në të kaluarën. Si e dini se çfarë ka funksionuar/nuk ka funksionuar? Sa të qëndrueshme janë provat ose të dhënat që keni përdorur për të vlerësuar atë që ka funksionuar/nuk ka funksionuar? Çfarë mësimesh ka marrë shkolla juaj për parandalimin e braktisjes?

Ju gjithashtu mund të përdorni mjetin e përgjithshëm të vetë-vlerësimit të shkollës për parandalimin e braktisjes së shkollës të paraqitur në Kapitullin 5.

DETYRA 2: SISTEMI I PARALAJMËRIMIT TË HERSHËM TË BRAKTISJES

Zhvilloni një SPH të thjeshtë të braktisjes për shkollën tuaj.

Hapi 1: Përzgjedhja e treguesve

1. Bazuar në listën e treguesve të dhënë në Hapin 1 më sipër, identifikoni treguesit që mund të përdoren për të identifikuar nxënësit në rrezik për të braktisur shkollën tuaj.
2. A mund të maten lehtësisht treguesit tuaj? Për shembull, nëse e keni identifikuar 'mungesën' si tregues, specifikoni numrin e orëve/ditëve të mungesës sipas të cilave nxënësi konsiderohet si i rrezikuar nga braktisja.
3. Rishikoni listën tuaj të treguesve dhe caktoni një koeficient ose nivel rreziku për treguesit më të rëndësishëm për t'u siguruar që nxënësit më të rrezikuar nga braktisja janë identifikuar saktë.

Hapi 2: Organizimi i identifikimit të nxënësve në rrezik të braktisjes në shkollën tuaj:

1. Identifikoni se kush duhet të jetë përgjegjës në shkollën tuaj për (i) mbledhjen dhe grumbullimin e të dhënave mbi treguesit SPH, (ii) kryerjen e vlerësimeve të nevojave të nxënësve, (iii) planifikimin e ndërhyrjeve parandaluese të braktisjes për nxënësit në rrezik, (iv) ndërmarrjen e menaxhimit të rasteve (koordinimi i ndërhyrjeve mbështetëse për parandalimin e braktisjes së shkollës për nxënësit në rrezik të braktisjes).
2. Hartoni mjetet e vlerësimit që do të përdorte shkolla juaj për të identifikuar nevojat specifike të nxënësve në rrezik braktisjeje.

Hapi 3: Identifikoni nxënësit që rrezikojnë të braktisin shkollën tuaj

1. Në bazë të sistemit që keni zhvilluar (treguesit, përgjegjësitë dhe procesi), krijoni një listë të nxënësve në klasën/shkollën tuaj që nuk janë kthyer në shkollë ose janë në rrezik të braktisjes.
2. Duke përdorur si shembuj disa fëmijë të identifikuar nën 1. më sipër, eksperimentoni me formatin e planit të parandalimit të braktisjes së nxënësve të propozuar në këtë modul. Çfarë rregullimesh duhet t'i bëhen shabllonit që ai të jetë plotësisht i përshtatshëm për kontekstin dhe shkollën tuaj?
3. Përshkruani masat dhe mekanizmat që shkolla juaj duhet të ndërmarrë për të siguruar që të gjitha të dhënat (letër dhe elektronike) të trajtuara në kuadër të aktiviteteve të parandalimit të braktisjes së shkollës do të mbrohen dhe ruhen në mënyrë të përshtatshme për të ruajtur konfidencialitetin.

DETYRA 3: PLANI I PARANDALIMIT TË BRAKTISJES SË SHKOLLËS

Hartoni një plan për parandalimin e braktisjes së shkollës.

Hapi 1. Bazuar në të gjitha aktivitetet dhe detyrat reflektuese të bëra përgjatë këtij manuali, përmbliidhni *Ku është shkolla juaj tani?* për sa i përket parandalimit të braktisjes:

1. Cilët janë nxënësit e shkollës suaj dhe cilët janë nxënësit që braktisin shkollën (profili)?
2. Cilat janë mjedisi i shkollës dhe praktikat e shkollës dhe stafit të shkollës që mund të kontribuojnë ose të zbusin braktisjen?
3. Çfarë ka funksionuar/nuk ka funksionuar në parandalimin e braktisjes së shkollës në shkollën tuaj në të kaluarën dhe cilat janë mësimet e nxjerra?

Nëse ju nevojitet një mjet shtesë për ta bërë këtë, përdorni mjetin e vetë-vlerësimit të braktisjes së shkollës, të ofruar në Kapitullin 6.

Hapi 2. Bazuar në të gjitha detyrat e bëra përgjatë këtij manuali, zhvilloni një plan për parandalimin e braktisjes së shkollës. Ju mund të përdorni modelin tuaj të planifikimit ose, nëse keni nevojë për një të tillë, shabllonin e dhënë në Aneksin X. Përfshini sa më shumë palë të interesuara në hartimin e planit tuaj: mësues, prindër, nxënës, anëtarë të komunitetit dhe agjenci të jashtme. Sigurohuni që plani juaj të përfshijë tregues për të matur progresin dhe arritjet.

Hapi 3: Identifikoni çdo nevojë për zhvillimin e kapaciteteve në mesin e stafit tuaj për të zbatuar planin, dhe gjeni mënyrat për t'iu përgjigjur nevojave të tyre për zhvillimin e kapaciteteve.

ANEKS 3. SHABLLON I PLANIT TË PARANDALIMIT TË BRAKTISJES SË SHKOLLËS

Analiza e situatës	[Identifikimi i çështjeve dhe problemeve kryesore bazuar në 'Ku jemi tani?' seksioni: Profili i nxënësve që braktisin shkollën dhe rrezikojnë të braktisin Analizë e mjedisit, strukturave, politikave, praktikave dhe përvojës së mëparshme të shkollës në parandalimin e braktisjes së shkollës – SWOT]				
Vizioni i shkollës	[Ku duam të jemi?]			Treguesit (ndikimi)	
Rezultati i pritur 1	[rezultat që do të kontribuojë në arritjen e vizionit]			Treguesit (rezultatet)	
Aktivitetet	Përshkrimi	Afati kohor	Përgjegjësia	Kosto/burimi i financimit	Treguesit
1.1					
1.2					
1.3					
Rezultati i pritur 2	[rezultat që do të kontribuojë në arritjen e vizionit]			Treguesit (rezultatet)	
Aktivitetet	Përshkrimi	Afati kohor	Përgjegjësia	Kosto/burimi i financimit	Treguesit
1.1					
1.2					
1.3					
Rezultati i pritur 3	[rezultat që do të kontribuojë në arritjen e vizionit]			Treguesit (rezultatet)	
Aktivitetet	Përshkrimi	Afati kohor	Përgjegjësia	Kosto/burimi i financimit	Treguesit
1.1					
1.2					
1.3					

1. Përsëritni objektivat dhe rreshtat e aktiviteteve sipas nevojës.

ANEKS 4. RASTE STUDIMORE PËR AFP

Rasti i parë

Graniti është një djalë 17-vjeçar, i cili aktualisht është i regjistruar në një shkollë profesionale në profilin automekanikë. Ai ka qenë gjithmonë i interesuar për makinat dhe i pëlqen të ndërhyjë te motorët dhe të zgjidhë problemet mekanike. Por, kohët e fundit Graniti po tregon disa tregues të rrezikut të braktisjes së programit të tij.

Së pari, ai ka munguar në disa orë mësimore, gjë që e ka bërë atë të mbetet prapa në lëndë të caktuara. Ai gjithashtu vjen shpesh vonë në klasë dhe duket i shkëputur gjatë procesit mësimor dhe aktiviteteve praktike. Për më tepër, Graniti ka probleme me menaxhimin e kohës dhe organizimin e tij, dhe në shumicën e rasteve nuk zbaton afatet për dorëzimin e detyrave ose nuk i dorëzon fare ato.

Gjithashtu, Graniti ka vetëbesim të ulët dhe i mungon besimi në aftësitë e tij. Ai heziton të bëjë pyetje në klasë ose të kërkojë ndihmë kur nuk e kupton një koncept ose detyrë. Kjo ka çuar në një mungesë progresi në lëndë të caktuara, pasi ai nuk po merr mbështetjen që i nevojitet për të pasur sukses.

Së treti, Graniti po përballet me disa sfida personale që po ndikojnë në performancën e tij akademike. Së fundmi ai ka kaluar në një ndarje me shoqen e tij të ngushtë dhe po përjeton probleme familjare në shtëpi. Këto sfida kanë bërë që ai të bëhet më i tërhequr dhe i hutuar në klasë, duke ndikuar më tej në aftësinë e tij për të pasur sukses në drejtimin që ka zgjedhur.

Së katërti, Graniti i mungon motivimi dhe një sens i qartë drejtimi për të ardhmen e tij. Ai nuk është i sigurt se çfarë rruge karriere dëshiron të ndjekë pas përfundimit të programit të tij, gjë që ka kontribuar në mungesën e angazhimit dhe përpjekjes së tij.

Së pesti, Graniti ka një qëndrim negativ ndaj shkollës dhe arsimit në përgjithësi. Ai e sheh atë si një punë të përditshme dhe nuk i pëlqen mënyra se si mësuesit e tij e organizojnë mësimin në klasë, gjë që ka ndikuar më tej në motivimin dhe angazhimin e tij në programin e tij.

Së gjashti, Graniti ka një historik të kaluar jo të mirë të përvojës së tij me shkollën dhe ka patur raste që duke qenë se nuk i kuptonte shumicën e koncepteve teorike që zhvilloheshin në klasë, nuk merrte më shumë se notën 6 nëpër testime. Kjo ka kontribuar në mungesën e besimit dhe motivimit të tij, pasi ai ndjen se nuk është i aftë të ketë sukses në shkollë.

Së fundi, Graniti i mungon një sistem i fortë mbështetjeje në grupin e shokëve të tij. Ai nuk ka asnjë shok të ngushtë në klasën e tij.

Rasti i dytë

Dreni është një djalë 18-vjeçar, i cili aktualisht është i regjistruar në një shkollë profesionale me profilin për kuzhinë-pastiçeri. Gjithmonë i ka pëlqyer gatimi dhe pjekja dhe ka ëndërruar që një ditë të bëhet shef kuzhine. Megjithatë, Dreni po shfaq disa tregues të rrezikut të braktisjes së programit të tij.

Së pari, Dreni ka munguar në disa orë mësimore, gjë që e ka bërë atë të mbetet prapa në disa lëndë. Ai gjithashtu vjen shpesh vonë në klasë dhe duket i shkëputur gjatë zhvillimit të mësimin. Megjithatë Dreni shfaq shumë interes gjatë aktiviteteve praktike.

Së dyti, Dreni po përballet me disa sfida personale që po ndikojnë në performancën e tij akademike. Ai po përballet me një situatë të vështirë familjare, pasi prindërit e tij po kalojnë një divorc dhe ai është duke luftuar për të përballuar pasojat emocionale. Këto sfida kanë bërë që ai të bëhet më i tërhequr dhe i hutuar në klasë, duke ndikuar më tej në aftësinë e tij për të pasur sukses në drejtimin që ka zgjedhur.

Së treti, Drenit i mungon motivimi dhe një sens i qartë drejtimi për të ardhmen e tij. Ndërsa i pëlqen të gatujë dhe të pjekë sidomos në pastiçeri tregon një talent të jashtëzakonshëm, ai nuk është i sigurt nëse të bëhet një kuzhinier është rruga e duhur e karrierës për të dhe ndihet i mbingarkuar nga kërkesat e shkollës.

Së katërti, Dreni u regjistrua në këtë shkollë sepse mendonte që do të kishte shumë aktivitete praktike, por si rezultat i ngarkesës së kurrikulës shkollore, ai ka filluar të jetë mospërfillës ndaj shkollës dhe arsimit në përgjithësi. Ai e sheh atë si një barrë dhe nuk i pëlqen procesi mësimor, gjë që ka ndikuar më tej në motivimin dhe angazhimin e tij në programin e tij.

Gjithashtu, Dreni po kalon dhe një periudhë jo të mirë shëndetësore, pasi ai ka probleme me ankthin dhe vetëvlerësimin e ulët, gjë që ka ndikuar në aftësinë e tij për të marrë pjesë në projekte në grup dhe për të bashkëpunuar me shokët e klasës.

Për më tepër, Drenit i mungojnë burimet financiare për të mbështetur arsimimin e tij. Familja e tij po kalon një kohë të vështirë financiare, gjë që ka ndikuar në aftësinë e tij për t'u fokusuar në lëndët e tij dhe për të marrë pjesë në aktivitete jashtëshkollore.

Rasti i tretë

Ambla është një vajzë 16-vjeçare e cila aktualisht është e regjistruar në një shkollë profesionale, me profilin për dizajn grafik. Ajo ka qenë gjithmonë e interesuar për artin dhe dizajnin dhe i pëlqen të krijojë ilustrime dhe grafika dixhitale. Megjithatë, Ambla po tregon disa tregues të rrezikut të braktisjes së programit të saj.

Ka disa javë që Ambla ka një rënie të theksuar në mësimet dhe ka filluar të mungojë shpesh sidomos në orët e para, gjë që ka bërë që ajo të mbetet prapa, sidomos në lëndët që zhvillohen në orët e para të mësimi. Edhe pas pushimit të madh, ajo gjithashtu shpesh vjen vonë në klasë dhe duket e shkëputur gjatë mësimi.

Ambla, gjithashtu po përballët me disa sfida personale që po ndikojnë në performancën e saj akademike. Babai i saj është oficer policie dhe ata zhvendosen shpesh nga një qytet në tjetrin. Në këto kushte Ambla, sa krijon shoqëri i duhet ta lërë për tu zhvendosur në një qytet tjetër dhe për të filluar gjithçka nga e para dhe për t'u përshtatur me mjedisin e saj të ri. Këto sfida kanë bërë që ajo të bëhet më e tërhequr dhe e hutuar në klasë, duke ndikuar më tej në aftësinë e saj për të pasur sukses në programin e saj.

Së treti, Amblës i mungon motivimi dhe një sens i qartë drejtimi për të ardhmen e saj. Ajo nuk është e sigurt se çfarë rruge karriere dëshiron të ndjekë pas përfundimit të shkollës, pasi i pëlqen shumë dhe modelingu, gjë që ka kontribuar në mungesën e angazhimit dhe përpjekjes së saj në kursin e saj.

Duke qenë se ka lëvizur nga një shkollë nëntëvjeçare në një tjetër, Ambla ka patur dhe mësues shumë të përgatitur, por dhe mësues shumë të dobët. Kjo ka ndikuar që njohuritë nga shkolla nëntëvjeçare mos ti ketë shumë të konsoliduara. Kjo ka ndikuar në mungesën e besimit dhe motivimit të saj, pasi ndihet sikur nuk është në gjendje të ketë sukses në shkollë.

Për më tepër, Amblës i mungojnë aftësitë e nevojshme teknike për programin e saj, gjë që e ka bërë atë të shfaqë mangësi të theksuara me disa nga detyrat dhe lëndët më të avancuara.

Së fundi, Amblës i mungon një sistem i fortë mbështetës në shtëpi pasi nëna e saj ka ndëruar jetë kur Ambla ka qenë fëmijë dhe i ati punon me turne 48 orëshe. Ambla thuhet gjithë kohën e kalon me gjyshen e saj nga babai, dhe me qenin e saj Çufo.

Rasti i katërt

Ema është një vajzë 18-vjeçare e cila aktualisht është e regjistruar në një shkollë profesionale me profil llogaritare. Ajo ka qenë gjithmonë e interesuar për financat dhe kontabilitetin dhe ka një dëshirë të madhe për t'u bërë një kontabiliste e certifikuar. Megjithatë, Ema po tregon disa tregues të rrezikut të braktisjes së programit të saj.

Së pari, Ema sapo është ndarë me të dashurin e saj (me të cilin kishte që në vit të parë që ishte lidhur) dhe po lufton për të përballuar pasojat emocionale. Ajo po përjeton ndjenja trishtimi dhe depresioni, gjë që ka bërë që ajo të humbasë fokusin dhe motivimin në shkollë.

Notat e Emës kanë filluar të bien dhe ajo e ka të vështirë të mbajë ritmin që kërkohet me kërkesat e kurrikulës. Ajo ka humbur mjaft orë mësimore dhe nuk është paraqitur në disa teste, gjë që ka ndikuar më tej në performancën e saj akademike.

Për më tepër, Ema po përballë me vështirësi financiare, pasi më parë gjithçka që i duhej ja mbulonte ish-i dashuri i saj. Prindërit e saj nuk i ka në gjendje të mirë ekonomike dhe tashmë është në vështirësi për të përballuar jetesën dhe për të paguar qoftë dhe librat e shkollës, gjë që e ka bërë atë të bëhet më e stresuar dhe në ankth.

Së katërti, Ema ka vështirësi të menaxhojë kohën e saj dhe të qëndrojë e organizuar. Ajo e ka të vështirë të balancojë ngarkesën e saj akademike me jetën e saj personale, dhe shpesh i humbet afatet për dorëzimin e detyrave të caktuara.

Gjithashtu, Ema ka përgjegjësi familjare që i marrin një pjesë të konsiderueshme të kohës së saj, pasi ajo duhet të kujdeset për vëllain e saj më të vogël, i cili sapo ka mbushur 10 vjeç, duke e çuar dhe marrë nga shkolla, duke u kujdesur për të përgjatë gjithë mbasdites, pasi prindërit vijnë vonë nga puna.

Rasti i pestë

Çelini, një djalë 17-vjeçar, aktualisht është i regjistruar në një shkollë profesionale, me profilin teknik hidraulik. Rrjedh nga një familje me të ardhura të ulëta dhe ka përjetuar disa ngjarje traumatike në jetën e tij. Çelini ka shfaqur një prirje për sjellje problematike dhe rrezikon të lërë shkollën.

Çelini po rritet në një lagje me të ardhura të ulëta dhe është shpesh dëshmitar i dhunës dhe abuzimit të substancave brenda familjes dhe komunitetit të tij. Prindërit e tij u divorcuan kur ai ishte i vogël dhe që atëherë ai ka jetuar me nënën dhe vëllezërit e motrat më të vegjël. Nëna e tij punon shumë punë për të siguruar familjen, dhe Çelini shpesh ndihmon me kohë të pjesshme një hidraulik për të kontribuar në të ardhurat e familjes. Duke qenë se kjo punë, i merr disa orë në javë, kjo gjë ka bërë që ai të ketë rezultate akademike të ulëta në shkollë në lëndët teorike. Ndërsa në lëndët praktike është më mirë.

Ndër të tjera, Çelini ka filluar të shfaqë disa tregues të rrezikut të braktisjes së arsimit profesional, duke përfshirë performancën e dobët akademike, mungesat e shpeshta, qëndrimin negativ ndaj shkollës, përfshirjen në sjellje devijante dhe mungesën e mbështetjes nga familja dhe bashkëmoshatarët. Ai ka marrë nota të dobëta në disa lëndë dhe ka munguar disa orë për shkak të punës dhe problemeve personale. Çelini është përfshirë në zënka me nxënës të tjerë dhe është kapur duke pirë marijuanë në mjediset e shkollës.

Ai gjithashtu shfaq qëndrim negativ ndaj shkollës dhe ka shprehur dëshirën për të lënë shkollën. Nëna e tij është mbështetëse për arsimimin e tij, por ajo nuk është se ka shumë kohë për ta ndihmuar atë.

ANEKS 5. BURIME SHITESË

Publikimet kryesore të Bashkimit Evropian për braktisjen e hershme të shkollës:

- Komisioni Evropian (2010) [Commission Staff Working Paper Reducing early school leaving. Accompanying document to the Proposal for a Council Recommendation on policies to reduce early school leaving](#), Bruksel: Komisioni Evropian.
- Komisioni Evropian (2011) Komunikimi nga Komisioni për Parlamentin Evropian, Këshillin, Komitetin Ekonomik dhe Social Evropian dhe Komitetin e Rajoneve. [Tackling early school leaving: A key contribution to the Europe 2020 Agenda](#), Bruksel: Komisioni Evropian..
- Grupi Tematik i Punës i Komisionit Evropian për braktisjen e hershme të shkollës (2013) [Reducing early school leaving: Key messages and policy support. Final Report of the Thematic Working Group on Early School Leaving](#). Nëntor 2013, Bruksel: Komisioni Evropian.
- Komisioni Evropian (2015) A [whole school approach to tackling early school leaving: Policy messages](#). Arsimit & Trajnim 2020, Politika e Shkollave: Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit dhe Kulturës.

Për më shumë informacion, shihni: http://ec.europa.eu/education/policies/european-policy-cooperation/et2020-framework_en

Burime të tjera të dobishme për parandalimin e braktisjes:

- School Education Gateway <https://www.schooleducationgateway.eu/en/pub/index.htm>
- Byroja e Malit të Zi për Shërbime Arsimore (2013) [Manual for professionals \(teachers, professional associates, principals, Roma and Egyptian assistants\) and all those who are interested in prevention of dropping out of schools in Montenegro](#). Podgorica: Ministria e Arsimit.
- Jovanović et al. (2016) [How to be a caring school? A study on the Effects of Prevention and Intervention Measures for Preventing the Dropout of Students from the Education System of the Republic of Serbia](#), Beograd: UNICEF, Qendra për Politika Arsimore, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Zhvillimit Teknologjik.
- Departamenti i Arsimit i Nova Scotia (2005) [Transition Planning for Students with Special Needs](#). Vitet e hershme deri në jetën e të rriturve.
- Victoria State Government (n.d.) [Transition Planning](#) [Online].
- Young Minds UK, [Transition Tips for Students with SEN](#)

Burime specifike për AFP

- Paketa e mjeteve CEDEFOP për AFP-në për lënien e hershme të shkollës <https://www.cedefop.europa.eu/en/tools/vet-toolkit-tackling-early-leaving>
- CEDEFOP Largimi i hershëm nga AFP <https://www.cedefop.europa.eu/en/country-reports/early-leaving-from-vet>
- UNESCO-UNEVOC AFP për të rinjtë e pafavorizuar <https://unevoc.unesco.org/home/UNEVOC+Publications/lang=en/akt=detail/qs=6492>
- UNESCO-UNEVOC Mësimi sipërmarrës për AFP <https://unevoc.unesco.org/home/UNEVOC+Publications/lang=en/akt=detail/qs=6437>
- Largimi i hershëm nga AFP - Qipro <https://www.cedefop.europa.eu/en/country-reports/early-leaving-vet-cyprus>

ANEKS 6. BIBLIOGRAFIA

Appleton, J., Christenson, S., Furlong, M. (2008) Student Engagement with School : Critical Conceptual and Methodological Issues of the Construct, in Psychology in the Schools, Vol. 45(5), 2008 Wiley Periodicals Inc.

Attendance Works <https://www.attendanceworks.org/chronic-absence/addressing-chronic-absence/monitoring-attendance-in-distance-learning/>

Australian Institute of Health and Welfare (2012) Social and emotional wellbeing: development of a Children's Headline Indicator. Cat. No.PHE 158. Canberra: AIHW.

Bélair, F (2009) Ma Classe-Qualité au secondaire. Des outils pratiques de gestion de classe inspirés par la Théorie du Choix. Les éditions de la Chenelière Inc

Borgna, C., Struffolino, E., (2017) Pushed or pulled? Girls and boys facing early school leaving risk in Italy, in Social Science Research, Volume 61, January 2017, Pages 298-313

California Department of Education (2018) Social-Emotional Development Domain. Last Accessed 23/12/2018 from <https://www.cde.ca.gov/sp/cd/re/itf09socemodev.asp>

Columbia University (2016) Collective Impact and The New Generation Of Cross-sector Collaborations For Education

Council for the Curriculum Examinations and Assessment of Northern Ireland (2014) Identifying and Supporting Learners with Social, Emotional and Behavioural Difficulties

Department for Children, Schools and Families (2009) Achievement for All: the Structured Conversation. Handbook to support training, London: Department for Children, Schools and Families.

Department of Education Northern Ireland (n.d.) Pupils' emotional health and wellbeing. Accessed on 06/01/2019 from <https://www.education-ni.gov.uk/articles/pupils-emotional-health-and-wellbeing>

Department of Education of South Australia (2013) Guidance in responding to children and young people. Last accessed on 18/03/2019 from <https://www.education.sa.gov.au/doc/guidance-responding-children-and-young-people>

Education Council (2018) Australian Student Wellbeing Framework. Last Accessed 27/12/2018 from https://www.studentwellbeinghub.edu.au/docs/default-source/aswf_booklet-pdf.pdf

Education Endowment Foundation (2018) [Teaching and Learning Toolkit](#).

Education Endowment Foundation (2018b) [Peer-tutoring](#) [Online].

EEF (2020) [Improving Social and Emotional Learning In Primary Schools. Guidance Report](#).

Eire Department of Education (2021), [Supporting the Wellbeing of School Communities as Schools Reopen: Guidance for Schools](#). Dublin: Eire Department of Education

Finn, J. D. (1993) School engagement and students at risk. Washington, DC. National Center for Education Statistics.

Foresight. (2008). Foresight Mental Capital and Wellbeing Project: Final Project Report. London: The Government Office for Science. Retrieved from: <http://www.bis.gov.uk/foresight/our-work/projects/current-projects/mental-capital-and-wellbeing>

Great Schools Partnership (n.d.) [The Glossary of Education Reform](#).

Harrington, I. (2005) The use of school discourses to understand boys early school leaving in Queensland, Australia. Paper presented at British Educational Research Association Annual Conference, University of Glamorgan, 14-17 September 2005.

Her Majesty Inspectorate of Education (2006) How Good Is Your School. Self-Evaluation Series. Partnership with parents.

Involve parents-Improve schools project (n.d.) [Online] Last Accessed 12/12/2018 from: <http://www.involve-migrants-improve-school.eu/>

Lavrentsova, E., Valkov, P. (2017) Dropping Out Of School: Risk and Protective Factors, ABOR et EDUCATIO nr 5/2017, DOI: 10.4467/25439561LE.17.006.7981

Lehr, C.A., Johnson, D.R., Bremer, C.D., Cosio, A., Thompson, M. (2004) Essential tools: Increasing Rates of School Completion: Moving From Policy and Research to Practice A Manual for Policymakers, Administrators, and Educators, Minneapolis: National Center on Secondary Education and Transition.

Lyche, C. S. (2010) Taking on the Completion Challenge. A Literature Review on Policies to Prevent Dropout and Early School Leaving. OECD Education Working Papers, No. 53, OECD Publishing. <http://dx.doi.org/10.1787/5km4m2t59cmr-en>

McLaughlin, C. (ed.) (2015) The Connected School: A Design for Well-Being – Supporting Children and Young People in Schools to Flourish, Thrive and Achieve, London: Pearson

McLeod, S. (updated 2018) [Maslow's Hierarchy of Needs](#). Simply Psychology [Online].

McMurtry, D. (2005) Understanding School Ethos. Presentation at the 'How Good is Our Ethos?' Conference, 7 June 2005.

Ministry of Education, Science and Technology of Kosovo and UNICEF (2014) [Equity in Education for All: Manual for School Prevention and Response Teams Towards Abandonment and Non-Registration in Compulsory Education](#).

OECD (2017) PISA 2015 Results (Volume III) Students' Wellbeing.

Rumberger, R. (1995) Dropping out of Middle School: A Multilevel Analysis of Students and Schools. American Educational Research Journal, Vol. 32, No. 3 (Autumn, 1995), pp. 583-625

Schraf, A. (n.d.) Critical Practices for Anti-bias Education, Montgomery: Teaching Tolerance.

Scottish Government (2008) Building positive relationship. A training programme for support staff.

Starr (2011) The Coaching Manual. Third Edition. Pearsons Education Limited.

Trickey, S., Coldwell, M., Holland, M., Close, P., Rybinski, D. (2005) Evaluation of Valued Youth: A National Peer-Tutoring Programme To Increase Self Confidence And Motivation. Paper presented to the European Conference on Educational Research, University College Dublin, 7-10 Sep 2005

UK Department of Education (2017) [Preventing and tackling bullying Advice for headteachers, staff and governing bodies](#)

UNESCO and UN Women (2016) Global Guidance on addressing school-related gender-based violence. Paris: UNESCO

UNICEF (2011) The Right of Roma Children to Education: Position Paper. Geneva: UNICEF Regional Office for Central and Eastern Europe and the Commonwealth of Independent States (CEECIS).

UNICEF (2012) The Right of Children with Disabilities to Education: A Rights-Based Approach to Inclusive Education. Geneva: UNICEF Regional Office for Central and Eastern Europe and the Commonwealth of Independent States (CEE/CIS).

UNICEF (2015a) A Rights-Based Approach to Inclusive Education for Children with Disabilities. UNICEF Regional Office for Central and Eastern Europe and the Commonwealth of Independent States (CEE/CIS).

UNICEF (2015b) Training of Trainers Modules on Inclusive Education. Available from <https://www.unicef.org/eca/education>

UNICEF (2015c) The Investment Case for Education and Equity, New York: UNICEF.

UNICEF (2017) Improving Education Participation. Policy and Practice Pointers for Enrolling All Children and Adolescents in School and Preventing Dropout. UNICEF Series on Education Participation and Dropout Prevention, Volume 2. Geneva: UNICEF Regional Office for Central and Eastern Europe and the Commonwealth of Independent States.

UNICEF (2018) Early Warning Systems for Students at Risk of Dropping Out. Improving Education Participation. Policy and Practice Pointers for Enrolling All Children and Adolescents in School and Preventing Dropout. Geneva: UNICEF Regional Office for Europe and Central Asia.

UNICEF (2018b) Child Marriage in Europe and Central Asia. UNICEF's Response: Regional Overview. Geneva: UNICEF ECARO.

UNICEF and Holt IS (2015) Ca este educația parentală? Last accessed on 10/12/2018 from: http://www.unicef.ro/wp-content/uploads/Ce-este-educatia-parentala_2015.pdf

UNICEF and Ministry of Education of Bulgaria (2018) Guidelines for School Enrolment Teams.

UNICEF and UIS (2016) Monitoring Education Participation: Framework for Monitoring Children and Adolescents who are Out of School or at Risk of Dropping Out. UNICEF Series on Education Participation and Dropout Prevention, Vol I. Geneva: UNICEF Regional Office for Central and Eastern Europe and the Commonwealth of Independent States.

UNICEF Serbia (2017) Kako do kvalitetne dopunske nastave –oslonci za unapređenje i primeri dobre prakse.

USAID (n.d.) [Introduction to gender responsive teaching methods.](#)

Welsh Government (2015) Family and community engagement toolkit. Accessible at <https://learning.gov.wales/docs/learningwales/publications/160712-face-toolkit-main-en.pdf>

WHO (2011a) [Evidence for gender responsive actions to promote well-being Young people's health as a whole-of-society response.](#) WHO Regional Office for Europe.

WHO (2011b) [Evidence for gender responsive actions to promote mental health Young people's health as a whole-of-society response.](#) WHO Regional Office for Europe.